



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ELBASAN
DDREJTORIA BUXHET FINANCË
SEKTORI I BUXHETIT

Nr. 4811 prot.

Elbasan më 27.08.2026

RELACION

“Detajim i shtesës së fondeve për SHMZSH-në”

Të nderuar Këshilltarë !

Bazuar në Aktin Normativ nr.2, datë 30.06.2026 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.87/2025”, “Për buxhetin e vitit 2026”, të ndryshuar, për njësite e vetëqeverisjes vendore është miratuar shtesë e fondeve në transfertën e pakushtëzuar sektoriale për funksionin e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimi.

Sipas shkresës nr.11214/3, datë 06.07.2026 “Mbi zbatimin e Aktit Normativ nr.2, datë 30.06.2026”, të Ministrisë së Financave, fondi i akorduar për Bashkinë Elbasan është 2,735,000 lekë. Këto fonde do të përdoren për shpërblimin e punonjësve zjarrfikës të cilët punojnë jasht kohës normale të punës si dhe gjatë ditëve të pushimit, në zbatim të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.536, datë 09.07.2026 “Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr.203, datë 10.04.2019, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e kriterëve, të masës së përfitimit dhe llojeve të pushimeve të tjera, me apo pa pagesë, në Shërbimin e Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimi”.

Sipas këtij vendimi, punonjësit do të marrin shtesa mbi pagë kur shërbejnë në turnet e natës si dhe në ditët e pushimit javor, apo të festave zyrtare.

Referuar udhëzimit nr.9, datë 20.03.2018 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit” dhe Udhëzimit Plotësues nr.2, datë 14.01.2026 “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2026”, fondet grant kanë nevojë për miratimin Tuaj në lidhje me përdorimin, duke ruajtur destinacionin në rastin e transfertës sektoriale.

Për sa më sipër, ju propozojmë të miratoni detajimin e shtesës së fondeve nga transfertat sektoriale (specifike), për vitin 2026 për SHMZSH- në, si më poshtë :

Funksioni	njësia shpenz.	shtesë fondi	art.600 (pagë)	art.601(sigurime)
Mbrojtja nga zjarri &shpëtimi	AMK	2,735,000	2,500,000	235,000

Duke Ju falënderuar për bashkëpunimin !

P.Sekt.Buxhetit: M.Beluli

Dr. Buxh. Fin.: A.Merkja


ZV/KRYETAR
Klaudia Krasnika



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ELBASAN
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. ____ . Prot.

Datë ____ .09. 2026

P/VENDIM

NR. ____ DATË ____ . 09. 2026

MBI

“Detajim i shtesës së fondeve për SHMZSH-në, për vitin 2026”.

Këshilli Bashkiak në mbledhjen e tij të datës ____ .09.2026, pasi mori në shqyrtim materialin e paraqitur nga Bashkia Elbasan mbi “Detajim i shtesës së fondeve për SHMZSH-në, për vitin 2026”, bazuar në ligjin nr.139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, ligjin nr.9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, ligjin nr.68/2017, datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, vendimin e Këshillit Bashkiak nr.154, datë 24.12.2025, për “Miratimin e Buxhetit të Bashkisë Elbasan për vitin 2026, si dhe miratimin e Programit Buxhetor Afatmesëm 2026-2028”, i ndryshuar, si dhe shkresën e Ministrisë së Financave, nr.11214/3, datë 06.07.2026,

VENDOSI

1. Detajimin e shtesës së fondeve nga transfertat sektoriale për Shërbimin e Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimi, për vitin 2026, si më poshtë :

Funksioni	njësia shpenz.	shtesë fondi/lekë	art.600 (paga)	art.601(sigurime)
Shërbimi MZSH	AMK	2,735,000	2,500,000	235,000

2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria Buxhet Financë dhe AMK.
3. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes së tij.

P/Sekt.Buxhetit : M.Beluli

Dr.Buxhet Finance : A.Merkja

D.P.SH.M: S. Mehmeti

Dr.Juridike: E. Arapi

SEKRETAR
Elsid Zyma

KRYETAR
Lutfi Lala



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ELBASAN

Nr. 4861 Prot.

Elbasan, më: 01.09.2026

RELACION

*Mbi miratimin e hapjes së rrugës
(Segmenti rrugor "Rozafa Fish City – Koder Labinot")*

KËSHILLIT BASHKIAK
K Ë T U

Të nderuar Këshilltarë,

Bazuar në ligjin Nr. 139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore", i ndryshuar; ligjin Nr. 7850 datë 29.07.1994 "Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar; ligjin nr. 107/2014 "Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit", i ndryshuar; ligjin nr. 44/2015 "Kodi i Proçedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë; V.K.M Nr. 205 datë 21.02.2008 "Për miratimin e listës së Inventarit të Pronave të Paluajtëshme shtetërore, në Komunën Gracen, të Qarkut të Elbasanit", VKM nr.888, datë 27.12.2022 "Për rastet e dhënies në përdorim dhe për ndryshimin e kategorisë së përdorimit, procedurat dhe dokumentacioni përkatës për ndryshimet e sipërfaqeve dhe pakësimin në volum nga fondi pyjor kombëtar apo zgjerimin e tyre"; VKM nr. 433, datë 8.6.2016 "Për transferimin në pronësi të bashkive të pyjeve dhe të kullotave publike, sipas listave të inventarit, dhe aktualisht në administrim të ministrisë së mjedisit e të ish-komunave/ bashkive" i ndryshuar; Drejtoria Përgjithshme e Planifikimi-Zhvillimit Urban dhe Shërbimeve Infrastrukturore, Drejtoria Juridike dhe Informacionit dhe Agjencia e Shërbimeve Publike Rurale (Drejtoria e pyjeve dhe bujqësisë) i relaton Këshillit Bashkiak për miratimin në parim të gjurmës së rrugës **Rozafa Fish City – Koder Labinot**, si në vijim:

Subjekti privat "Rozafa" Sh.p.k, i është drejtuar Bashkisë Elbasan me shkresën Nr. 1905 Prot., datë 20.08.2026, për kryerjen e një investimi i cili parashikon ndërtimin e segmentit rrugor me fondet e veta nga Rozafa Fish City – Kodër Labinot. Duke qënë që subjekti në fjalë ka në përdorim një sipërfaqe pyjore prej rreth 44 ha me kontratë qiraje me objekt kontrate: Mbarështimin e faunës së egër, objekt gjuetie në zonën e Griqanit të Poshtëm, referuar ligjit 57/2020 'Për Pyjet', i ndryshuar, neni 22, pika 3, thuhet shprehimisht: *Personat juridikë ose fizikë, që kanë marrë pyje në përdorim ose shfrytëzim sipas legjislacionit në fuqi, ndërtojnë,*


riparojnë dhe mirëmbajnë infrastrukturën pyjore me mjetet e tyre financiare. Në rastin kur ndërtojnë rrugë të reja, shpenzimet reflektohen në tarifat e reduktuara të lëndës drusore.

Mbështetur në bazën ligjore të mësipërme si dhe duke vlerësuar veteafirmimin e subjektit të mësipër për të kryer të gjithë shërbimet përkatëse për hapjen e kësaj traseje të re rrugore përfshirë edhe hartimin e detajuar të projektit. Bashkia Elbasan dakortësohet për ndjekjen e proceduarve të mëtejshme administrative mbështetur në aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi me qëllim që ky projekt të konkretizohet.


Ky segment rrugor me gjatësi totale prej 1451 ml, mbivendoset mbi fondin pyjor publik të Bashkisë Elbasan në gjatësin 1205 ml (246-1451 ml). Projekti do të ketë impakt të madh pozitiv dhe do të shërbej kryesisht për:

- Aksesin dhe administrimin e sipërfaqeve në pronësi dhe përdorim të shoqërisë;
- Mbrojtjen dhe menaxhimin e territorit;
- Krijimin e një korridori funksional për parandalimin dhe luftimin e zjarreve;
- Mundësimin e hyrjes së mjeteve të emergjencës dhe mjeteve të ndërhyrjes;
- Kontrollin dhe monitorimin e sipërfaqeve pyjore dhe të faunës së egër;
- Përmirësimin e aksesit në zonë dhe rritjen e sigurisë së territorit;
- Mbështetjen e veprimtarisë së mbarështimit dhe ruajtjes së faunës së egër;

Nisur nga sa më sipër, gjurma e projektit të paraqitur shtrihet në pasuritë e detajuara në planvendosjen bashkëlidhur, ku një pjesë e të cilave janë në pronësi të Bashkisë Elbasan.




Në kuadër të këtij projekti, Bashkia përfiton projektin e hartuar nga subjekti privat sipas detyrës së projektimit të hartuar nga Bashkia Elbasan dhe investimin e segmentit nga Rozafa Fish City – Kodër Labinot, ky investim në fund i ngelet Bashkise. Sqarohet se një pjesë e rrugës prej gjatësisë 0-246 m do ndërtohet në pronën private të subjektit ndërsa pjesa tjetër do të ndërtohet në fond pyjor në pronën e Bashkise Elbasan.



SKEMA E VENDOSJES SË ZHVILLIMIT
SHKALLA 1 : 7500

POZICIONI KADASTRAL I RRUGËS
SHKALLA 1 : 6000



Kjo gjurme e re rrugore me nje gjatesi totale prej 1451 ml do te hapet trase e re e gjitha me nje gjeresi rruge 6.0 m dhe me trotuar 2.2 m ne nje krahe të rruges.

Ky aks i ri qe do te ndertohet do tu bazohet kushteve te projektimit dhe do te plotesoj keto parametra:

- Trup rruge 6.0 m
- Trotuar, ne nje krah të rruges me gjeresi 2.2 m
- Bordurë maturuese 0.15 m.
- Gjërësia totale 8.35 m

Përshkrim i shkurtër i vendndodhjes, karakteristikave stacionale dhe rivlerësime

N/ngastra pyjore nr. 122a (*pasuria kadastrale nr. 533, ZK 2355*) e ekonomisë pyjore 'Zaranikë', në vendin e quajtur Vreshta e Bicet, në pronësi dhe administrim të Bashkisë Elbasan shtrihen në afërsi të fshatit Griqan Poshtë, Njësia Administrative Labinot-Fushë, në anën e majtë të rrugës nacionale Elbasan-Librazhd. N/ngastrat pyjore nr. 122a është tokë me kategori përdorimi pyll (shkurre) me llojin mret, shkozë, etj. Keto prona jane te rregjistruara ne ASHK me nr pasurie zk...

Është tokë e thellë që shkon nga 50 deri në 120 cm, pothuaj e freskët, me reaksion neutral dhe teksturë argjilore.

Lëgusha mungon. Gurët në sipërfaqe, në 5% të saj.

Bimësia barishtore (graminace).

Bimët me vlera mjeksore, eterovajore dhe industriale natyrore, mungojnë.

N/ngastra nr. 1a (*pasuria kadastrale nr. 534, ZK 1866*), ekonomia pyjore 'Labinot' duke qënë ngjitur me n/ngastren nr.122a të ekonomisë pyjore Zaranikë ka pothuzajse të njëjtat kushte stacionale.

Bashkëlidhur këtij relacioni gjeni materialin plotësues, i cili përmban:

Planvendosjen e përgjithëshme të projektit të rrugës 'Rozafa Fish City – Kodër Labinot' të mbivendosur mbi hartën kadastrale dhe ortofoto.

Treguesit identifikues të n/ngastrës, bazuar në të dhënat e regjistrit kadastral pyjor dhe kullosor si dhe Planit të Inventarizimit, identifikimin sipas listës së pronave, ekonomia, n/ngastra, sipërfaqja, qëllimi i përdorimit, treguesit kadastralë, etj.

Për sa më sipër, Drejtoria e Përgjithshme e Planifikim-Zhvillimit Urban dhe Shërbimeve Infrastrukturore, Drejtoria Juridike dhe Informacionit, Agjencia e Shërbimeve Publike Rurale (*Drejtoria e Pyjeve dhe Bujqësisë*) i relatton Këshillit Bashkiak të miratojë gjurmën e rrugës Rozafa Fish City-Kodër Labinot.

Konc.: A. Bitri

Pranoi: J. Bodurri

Miratoi: E. Hazizolli

KRYETARI
Gledian Llatja

NË MUNGESË DHE ME URDHËR

ZV/KRYETAR

Klaudia Krasnika





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ELBASAN
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. _____ Prot.

Elbasan, më ____ . ____ .2026

PROJEKT - VENDIM

Nr. _____ Datë _____ / _____ /2026

“Mbi miratimin në parim të gjurmës së rrugës Rozafa Fish City – Kodër Labinot”

Këshilli Bashkiak në mbledhjen e tij të datës ____ / ____ /2026, pasi shqyrtoi materialin e paraqitur nga administrata e Bashkisë në lidhje me hapjen e rrugës së re Rozafa Fish City – Kodër Labinot, bazuar në ligjin 139/2015 “Për vetqeverisjen vendore” nenet 8, 9, 23 54 të tij,

V E N D O S I

- 1- Të miratojë në parim hapjen e rrugës së re Rozafa Fish City – Kodër Labinot, me gjatësi 1451 ml, ku 1205 ml mbivendosen mbi fondin pyjor të Bashkisë Elbasan, plan-vendosja bashkangjitur është pjesë e këtij vendimi.
- 2- Projektimi dhe ndërtimi i rrugës të bëhet sipas kriterëve dhe standarteve teknike-ligjore të parashikuar në aktet ligjore e nënligjore në fuqi.
- 3- Ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Planifikim-Zhvillimit Urban dhe Shërbimeve Infrastrukturore dhe Agjensia e Shërbimeve Publike Rurale me zbatimin e këtij vendimi.
- 4- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë

Konceptoi: A. Bitri

Pranoi: J. Bodurri

Miratoi: E. Hazizolli

Dr. Juridike: E. Arapi

Sek. K. Bashkiak
Elsid Zyma

KRYETARI
Lutfi Lala



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ELBASAN
AGJENCIA E SHËRBIMEVE PUBLIKE RURALE
DREJTORIA E PYJEVE DHE BUJQËSISË

Shtojca nr. 1

R A P O R T

MBI STUDIMIN TEKNIKO-EKONOMIK PËR NDËRTIMIN E RRUGËS “ROZAFI FISH CITY – KODËR LABINOT”

Bazuar në urdhërin nr. 334, datë 30.04.2026 “Për ngritjen e grupit të përhershëm të punës për hartimin e studimeve teknike-ekonomike për dhënien në përdorim, heqjen dhe shtimin nga fondi pyjor/kullosor publik”, grupi i punës i përbërë nga: z. Jakov Bodurri_Përgjegjës i Sektorit të Menaxhimit të pyjeve dhe kullotave, z. Astrit Çeka_Specialist i Menaxhimit të Pyjeve dhe zj. Aurora Bitri_Specialiste e Kadastrës Pyjore nga data 24.08.2026 deri në datën 28.08.2026, studioj dokumentacionin e përgjithshëm të miratimit të ndërtimit të rrugës ‘Rozafi Fish City – Kodër Labinot’, realizoi verifikimin në regjistrin kadastral dhe në terren të sipërfaqes pyjore që mbivendoset mbi fondi pyjor publik, sipas gjurmës së miratuar nga bashkia dhe si rezultat i mbivendosjes së gjurmës së projektit të rrugës Rozafi Fish City – Kodër Labinot, mbështetur në të dhënat e regjistrit kadastral, rezultojnë se sipërfaqja që preket nga gjurma e rrugës është:

- **Për hapje traseje rrugore të re = 1 ha** që prek përkatësisht n/ngastrat pyjore nr. 1a ekonominë pyjore “Labinot” me gjatësi lineare 1080 m dhe 122a në ekonominë pyjore “Zaranikë” me gjatësi lineare 125 m, ZK 2355, 1866 (Planvendosja përkatëse bashkëlidhur);

Përshkrimi parcellar i sipërfaqes objekt studimi dhe kategoria e përdorimit të saj, pasqyrohen në tabelën nr.1 dhe 2 të këtij raporti.

Nga verifikimi në terren rezultojnë kjo gjendje: (lexo tabelat përkatëse 1 dhe 2).

Ndërhyrja e propozuar që pasqyrohet në dokumentacionin e paraqitur nga struktura përkatëse e Bashkisë Elbasan (projekti teknik, planvendosja, etj.), ndryshon kategorinë e përdorimit të territorit, funksionin, formën e qeverimit dhe treguesit kryesorë të grumbullit në n/ngastrën pyjore nr. 1a në ekonominë pyjore “Labinot” dhe 122a në ekonominë pyjore “Zaranikë”, por infrastruktura lineare nuk e kalon gjërësinë 10 m për këtë arsye mbështetur në VKM nr. 888, datë 27/12/2022 nuk hiqet nga fondi pyjor i Bashkisë Elbasan, por për efekt kadastral bëhet vetëm zvogëlimi në volum, jo në sipërfaqe. (pasqyra nr. 4).

Procedurat që ndiqen për dhënien në përdorim/heqjen të fondit pyjor publik janë të mbështetura në VKM-në nr.888, datë 27.12.2022 “Për rastet e dhënies në përdorim dhe për ndryshimin e kategorisë së përdorimit, procedurat dhe dokumentacioni përkatës për ndryshimin e kategorisë së përdorimit, procedurat dhe dokumentacioni përkatës për ndryshimet e sipërfaqeve dhe pakësimin në volum nga fondi pyjor kombëtar apo zgjerimin e tyre”; VKM-në nr.1374, datë 10.10.2008 “Për rregullat dhe procedurat që ndiqen për heqjen, shtimin dhe ndryshimin e destinacionit të fondit kullosor”, të ndryshuar; VKM_në nr.433, datë 8.6.2016 “Për transferimin në pronësi të bashkive të pyjeve dhe të kullotave publike...”, i ndryshuar me

VKM nr.684, date 02.09.2020 dhe VKM në nr. 559, datë 29.07.2022 "Për përcaktimin e tarifave për dhënie në shfrytëzim/përdorim të fondit pyjor kombëtar, për veprimtari ekonomike, si dhe për prodhimet drusore dhe jodrusore pyjore".

Materiali drusor që do dali nga mbivendosja e gjurmës së rrugës do të vlerësohet nga struktura e pyjeve në bashki dhe do të shitet nëpërmjet ankandit publik nga autoriteti kontraktor (Bashkia Elbasan) ose do të përdoret për nevojat e vetë bashkisë (për interesat publike).

Shuma në lekë/vit konsiston në:

a) Vlera e përdorimit të sipërfaqes pyjore lekë/ha/vit është			= 0 lekë/vit
Trungishte	_____ ha x _____	lekë/ha/vit	= 0 lekë/vit
Cungishte	_____ ha x _____	lekë/ha/vit	= 0 lekë/vit
Shkurre+kullotë	_____ ha x _____	lekë/ha/vit	= 0 lekë/vit
Inproduktive ... etj	_____ ha x _____	lekë/ha/vit	= 0 lekë/vit
Tokë me bim.pyjore	_____ ha x _____	lekë/ha/vit	= 0 lekë/vit

(Plotësohet vetëm për rastet e dhënies në përdorim si sipërfaqe)

Vlera e përdorimit për linja gjatësore në km është 42,175 lekë/vit

Trungishte	km x _____	lekë/km/vit = lekë/vit
Cungishte	km x _____	lekë/km/vit = lekë/vit
Shkurre + kullotë	1.205 km x 35,000 lekë/km/vit	= 42,175 lekë/vit
Tokë me bim.	km x _____	lekë/km/vit = lekë/vit
Inproduktive, etj.	km x _____	lekë/km/vit = lekë/vit

(Duke specifikuar përdorimin për kanalet, tubacionet, linjat e tensionit të lartë etj. Në rastet e HEC-eve).

b) Vlera e bimësisë pyjore, florës dhe faunës është 5,400 lekë, e përbërë nga:

1. Vlera e lëndës së punimit $m^3 \times \text{lekë}/m^3 = \text{_____ lekë}$
2. Vlera e druve të zjarrit $9 m^3 \times 600 \text{ lekë}/m^3 = 5,400 \text{ lekë}$
3. Vlera e prodhimeve të dyta pyjore = _____ lekë
4. Kullotja = _____ lekë
5. Vlera e faunës = _____ lekë
6. Vlera e investimeve (pyllëzime, zëvend., përmirësime, etj) = _____ lekë
7. Të tjera = _____ lekë

(përfshihet volumi dhe vlera për gjithë sipërfaqen që hiqet dhe jepet në përdorim)

PËRPILUESIT E RAPORTIT TEKNIKO-EKONOMIK

Pergj. Sekt.Admin.-Menaxhimit

Jakov Bodurri



Specialist i Admin.- Menaxh.

Astrit Çeka



Specialisti i Kadastrës

Aurora Bitri



DREJTORI


Eraldo Hazizolli



**MIRATOI
KRYETARI I BASHKISË
Gledian Llatja**

NË MUNGESË DHE ME URDHËR

**ZV/ KRYETARI
Klaudia Krasniqa**





BASHKIA ELBASAN
AGJENCIA E SHËRBIMEVE PUBLIKE RURALE
DREJTORIA E PYJEVE DHE BUIQËSISË

**PASQYRË E PËRSHKRIMIT PARCELAR SIPAS RREGJISTRIT KADASTRAL I SIPËRFAQES PYJORE QË PREKET NGA RRUGA
PËR NDËRTIMIN E SEGMENTIT RRUGOR 'ROZAFI FISH CITY - KODËR LABINOT' NGA BASHKIA ELBASAN**

Tabela nr.1

ID Pronës	Ekonomia Pyjore	Parcela	Përbëja e grumbullit	Funksioni	Forma e qeverisjes	Të dhëna të grumbullit pyjor					Fuqia lëndore		
						Mosha	KD	D. mes.	Lartësia mesatare	Filizëria	Nënpylli	Katet	Total
1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12	13	14
EL37 00 001a	Labinot	1a	Shkz	Prodhues	Shkurre	15	0.9	4	3	mungon	mungon	Një kat	8.5
EL70 00 122a	Zaranikë	122a	Shkz+Mret	Prodhues	Shkurre	15	1	3.8	3	mungon	mungon	Një kat	7.9
Shuma:												16.4	637

**PASQYRË E PËRSHKRIMIT PARCELAR SIPAS VERIFIKIMIT NË TERREN I SIPËRFAQES PYJORE QË PREKET NGA RRUGA
PËR NDËRTIMIN E SEGMENTIT RRUGOR 'ROZAFI FISH CITY - KODËR LABINOT' NGA BASHKIA ELBASAN**

ID Pronës	Ekonomia Pyjore	Parcela	Përbëja e grumbullit	Funksioni	Forma e qeverisjes	Të dhëna të grumbullit pyjor					Fuqia lëndore		
						Mosha	KD	D. mes.	Lartësia mesatare	Filizëria	Nënpylli	Katet	Total
1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12	13	14
EL37 00 001a	Labinot	1a	Shkz	Prodhues	Shkurre	15	0.9	4	3	mungon	mungon	Një kat	8.5
EL70 00 122a	Zaranikë	122a	Shkz+Mret	Prodhues	Shkurre	15	1	3.8	3	mungon	mungon	Një kat	7.9
Shuma:												16.4	637

Shënim: Të dhënat e mësipërme janë plotësuar sipas përshkrimit parcelar, karakteristikave stacionale dhe karakteristikave të grumbujve pyjor, mbështetur në Planin e Mbarëshimit të EP 'Kushë-2' të vitit 2022. Nga verifikimi në terren i gjendjes kadastrale, konstatohet se territori dhe përberja është e njëjte nga përshkrimi në Plan.

Plotësoi: Specialisti i Kadastrës

Aurora BITRI

Specialisti Admin.-Menaxhimit

Astrit ÇEKA

Përgj. Sektorit Menaxhimit dhe Mbrojtjes

Jakov BODURRI

DREJTORI

Eraldo Hazizolli

Firmë dhe vulë



AGENCIA E SHËRBIMEVE PUBLIKE RURALE
DREJTORIA E PYJEVE DHE BUJQËSISË

TABELË E PËRSHKRIMIT TË SIPËRFAQES KULLLORE QË DO TË HIQET OSE JEPET NË PËRDORIM NGA FONDI PYJOR PËR NDËRTIMIN E SEGMENTIT RRUGOR ‘ROZAFI FISH CITY – KODËR LABINOT’ NGA BASHKIA ELBASAN

Tabelē nr. 2

[illegible]

**Plotësoi: Specialisti i Kadastrës
Aurora BITRI**

Specialisti Admin.-Menaxhimit
Astrit ÇEKA

Përgj. Sektorit Menaxhimit dhe Mbrojtjes
Jakov BOÇURRI

DIRETTORI
Eraldo Hazizolli

Firmë dhe vule:



BASHKIA ELBASAN
AGJENCIA E SHËRBIMEVE PUBLIKE RURALE
DREJTORIA E PYJEVE DHE BUJQËSISË

INVESTIME TË KRYERA NË VITE
MBI SIPËRFFAQEN PYJORE QË MBIVENDOSËT GJURMA E RRUGËS 'ROZAFI FISH CITY - KODËR LABINOT'
OBJEKTI: _____

Tabela nr. 3

ID Pronës	Përdorimi	Ekonomia Pyjore	Parcela	Sip. totale ha.	Sip. me punime	Viti i kryerjes punimeve	Punimi i kryer në ha		Vlera investimit lekë
							pyllëzime	përmirësime	
EL37 00 001a	Pyll	Labinot	1a	36.25	-	-	-	-	-
EL70 00 122a	Pyll	Zaranikë	122a	41.39	-	-	-	-	-
Shuma gjithësej:									

Kjo tabelë plotësohet nëse ka pasur investime të realizuar në vite.

Plotësoi: Specialisti i Kadastrës
Aurora BITRI

Specialisti Admin.-Menaxhimit
Astrit ÇEKA

Përgj. Sektorit Menaxhimit dhe Mbrojtjes
Jakov BODURRI

DREJTORI
Eraldo Hazizolli
Firmë dhe vulë



BASHKIA ELBASAN
AGJENCIA E SHËRBIMEVE PUBLIKE RURALE
DREJTORIA E PYEVE DHE BUIQËSË

TABELË PËRMBLEDHËSE E VLERËSIMIT FINANCIAR
PËR NDËRTIMIN E SEGMENTIT RRUGOR 'ROZAFA FISH CITY - KODËR LABINOT' NGA BASHKIA ELBASAN

Tabela nr. 4

Përdorimi i territorit	Sip. Ha	Bashkia	Volumi m³ sipas asortimenteve	Vlera		Ndërtim/përdorim rrugë				Për shtrirje tubacionesh (km)			Gjatësia Përd. (Linjë) Km	Tarifa dhënë në përdorim lekë/km/vit			Shuma III Lekë/vit	TOTALI I+II+III Lekë	
				lekë/m²	Shuma Lekë	Rrugë (Km)	Tarifa (Lekë/km)	Shuma I (Lekë/vit)	Tub./km	Tarifa (Lekë/km)	Shuma II Lekë	1		1 deri 5	6 deri 10				
1	2	3	4			5	6	7	8	9		10	11	12	13	14	15		
Trungishte	3	Elbasan	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0		
			0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	
			0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	
Cungishte	0	“	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0		
			0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	
			0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	
			0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	
Shkurre	1	“	D.z (9)	600	5,400	1,205	35,000	42,175	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	47,575		
			Kullotë	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	
			Bimësi pyjore + djerr	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0
			Inprodukte	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0
Gjuetia Investime/realizuar	0	“	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0		
			0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	
			0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	
Shuma gjithësej:			1		5,400			42,175									47,575		

Shënim: Kollona 5=3x4; kollona 10= 6 x njëzën nga koll. 7-9; Kollona 12= 6+11. Për volumet psh trung, shihen rrethat sipas asortimenteve x vlerën e asortimentit dhe kështu me rradhë.

Plotësoi: Specialisti i Kadastrës
Aurora BITRI

Specialisti Admin.-Menaxhimit
Astrit ÇEKA

Përgj. Sektorit Menaxhimit dhe Mbrojtjes
Jakov BODURRI

DREJTORI
Eraldo Hazizolli
Firmë dhe vulë



BASHKIA ELBASAN
AGJENCIA E SHËRBIMEVE PUBLIKE RURALE
DREJTORIA E PYJEVE DHE BUIQËSISË

**LISTA E NGASTRAVE DHE N/NGASTRAVE QË JEPEN NË PËRDORIM DHE HIQEN NGA FONDI PYJOR DHE KULLOSOR PUBLIK
PËR NDËRTIMIN E SEGMENTIT RRUGOR 'ROZAFI FISH CITY - KODËR LABINOT' NGA BASHKIA ELBASAN**

Tabela nr.5

Nr.	ID pronës	Ekonomia pyjore/kullosore	Ngastrat n/ngastra	Sip. që hiqet nga fondi pyjor/kulloros ha	Sip. që jepet në përdorim nga fondi pyjor/kulloros ha	Gjatësia në përdorim Km		
						Rrugë	Linjë	Tubacion/kanal
1.	EL37 00 001a	Labinot	1a	0	0	0	0	0
2.	EL70 00 122a	Zaranikë	122a	0	0	0	0	0
Shuma gjithësej:				0	0	0	0	0

Shënim: Në rastin e Hec-ëve, rrugëve apo linjave gjatësore, plotësohet e gjithë tabela. Kolona 6 llogaritet në sipërfaqe për efekt të llogaritjes së vëllimit të materialit të kërkuar nga MTM dhe procedurave sipas VKM nr.888 dt.27.12.2022

miniera, rrugë, ujë, plotësohet tabela deri në kolonën 5.

1. Zvogëlimi i sipërfaqes dhe vëllimit të materialit të kërkuar nga MTM dhe procedurave sipas VKM nr.888 dt.27.12.2022

Plotësoi: Specialisti i Kadastrës
Aurora BITRI

Specialisti Admin.-Menaxhimit
Astrit ÇEKA

Përgj. Sektorit Menaxhimit dhe Mbrojtjes
Jakov BODURRI


DREJTORI
Eraldo Hazizolli

Firmë dhe vulë



BASHKIA ELBASAN
AGJENCIA E SHERBIMEVE PUBLIKE RURALE
DREJTORIA E PYJEVE DHE BUJQËSISË

PLAN-VENDOSJA E SEGMENTIT RRUGOR 'ROZAFI FISH CITY' - KODËR LABINOT'



SPECIALISTI I KADASTRËS
Aurora Bitri

PËRGJEGJËSI SEKTORIT
Jakov Boçurri



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ELBASAN
DREJTORIA E POLITIKAVE TË BUJQËSISË, PYJEVE, MJEDISIT, STATISTIKAVE DHE
PERFORMANCËS
SEKTORI I STATISTIKAVE DHE PERFORMANCËS

Nr. 4742 prot.

Elbasan, më 20.08.2026

Relacion

Lënda: Për informimin e Këshillit Bashkiak mbi Raportin Vendor të Performancës së Bashkisë Elbasan për vitin raportues 2025

I. QËLLIMI

Raporti Vendor i Performancës 2025 paraqet rezultatet e monitorimit dhe vlerësimit të performancës së Bashkisë Elbasan në ushtrimin e funksioneve dhe ofrimin e shërbimeve publike vendore.

Raporti është hartuar në kuadër të Sistemit të Matjes së Performancës (SMP), sipas metodologjisë së Agjencisë për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore (AMVV), dhe mbështetet në krahasimin e rezultateve të viteve **2024–2025**.

Qëllimi i paraqitjes së tij për informim në Këshillin Bashkiak është të ofrojë një panoramë të përmbledhur dhe të matshme mbi rezultatet e administratës vendore, progresin e arritur, fushat që kërkojnë përmirësim dhe orientimet për ndërhyrjet e mëtejshme.

Raporti nuk synon vetëm evidentimin e të dhënave statistikore, por përdorimin e tyre si instrument për **transparencën, llogaridhënien, planifikimin dhe vendimmarrjen e bazuar në evidencë**.

Gjatë procesit të hartimit, të dhënat janë mbledhur nga strukturat përgjegjëse të Bashkisë, janë verifikuar dhe analizuar nga struktura përgjegjëse për statistikën dhe performancën dhe janë validuar në bashkëpunim me ekspertët e projektit **“Bashki të Forta”**. Në kuadër të këtij procesi, praktika e Bashkisë Elbasan për organizimin dhe validimin e treguesve të performancës është vlerësuar pozitivisht.

II. PANORAMA E PËRGJITHSHME E PERFORMANCËS 2025

Rezultatet e vitit 2025 tregojnë në tërësi një **performancë të qëndrueshme dhe në përmirësim**, me progres të dallueshëm në disa prej funksioneve kryesore të Bashkisë.

Ndër rezultatet më të rëndësishme evidentohen: ruajtja e mbulimit 100% me shërbimin e menaxhimit të mbetjeve; mirëmbajtja 100% e çerdheve, kopshteve dhe shkollave publike; rritja e fondit pyjor dhe kullësor të mbuluar me Plane Vendore të Mbarështimit nga 55% në 69.19%; rritja e efektivëve zjarrfikës nga 31 në 41; forcimi i kapaciteteve profesionale të administratës; konsolidimi i transparencës dhe qeverisjes së hapur; rritja e përfaqësimit të grave në drejtim dhe vijimi i përthithjes së fondeve të Bashkimit Evropian.

Njëkohësisht, monitorimi evidenton nevojën për të orientuar më tej politikat dhe investimet drejt modernizimit të infrastrukturës dhe shërbimeve, transformimit digjital, përshtatjes ndaj ndryshimeve demografike dhe klimatike, forcimit të autonomisë financiare dhe rritjes së përdorimit të të dhënave në vendimmarrje.

III. PANORAMA SIPAS FUSHAVE

1. Arsimi Parauniversitar

Rezultati. Performanca paraqitet e qëndrueshme dhe në përmirësim. Është ruajtur mirëmbajtja në masën **100%** e çerdheve, kopshteve dhe shkollave 9-vjeçare publike; regjistrimi në çerdhe është rritur në **97.11%**, ndërsa janë rritur edhe shpenzimet mesatare për institucionet arsimore.

Risia 2025. Miratimi dhe fillimi i zbatimit të **Planit Vendor të Arsimit Parauniversitar**, duke krijuar një bazë të strukturuar për planifikimin dhe monitorimin afatgjatë të sektorit.

Sfida. Përshtatja e rrjetit arsimor me ndryshimet demografike, krahas vijimit të modernizimit të infrastrukturës, veçanërisht në zonat rurale.

2. Menaxhimi i Infrastrukturës së Ujitjes dhe Kullimit

Rezultati. Performanca paraqitet e qëndrueshme. Mbulimi i tokës bujqësore me sistem ujitjeje/kullimi është ruajtur në **44.73%**, ndërsa funksionaliteti i përgjithshëm i rrjetit në **64.40%**.

Risia 2025. Vijimi i mirëmbajtjes sistematike ka garantuar funksionalitetin e **174.5 km kanaleve ujitëse dhe kulluese**, duke ruajtur vazhdimësinë e shërbimit për sektorin bujqësor.

Sfida. Kalimi nga ruajtja e nivelit ekzistues drejt zgjerimit të mbulimit dhe rehabilitimit të rrjetit, rritjes së eficiencës së përdorimit të ujit dhe përshtatjes ndaj thatësirave dhe ndryshimeve klimatike.

3. Administrimi i Pyjeve dhe Kullotave

Rezultati. Performanca paraqitet pozitive dhe në përmirësim, me progres të dukshëm në planifikimin dhe administrimin e fondit pyjor dhe kullor.

Risia 2025. Sipërfaqja e fondit pyjor dhe kullor e mbuluar me Plane Vendore të Mbarështimit arriti në **38,042.3 ha**, duke rritur shkallën e mbulimit nga **55% në 69.19%**.

Sfida. Përfundimi i procesit të mbulimit të fondit me Plane Vendore të Mbarështimit, digjitalizimi i monitorimit dhe forcimi i masave për mbrojtjen nga zjarret, prerjet e paligjshme dhe ndikimet e ndryshimeve klimatike.

4. Mbrojtja nga Zjarri dhe Shpëtimi

Rezultati. Performanca paraqitet pozitive, me përmirësim të ndjeshëm të kapaciteteve njerëzore dhe ruajtje të kapaciteteve logjistike të shërbimit.

Risia 2025. Numri i efektivëve zjarrfikës u rrit nga **31 në 41**, duke përmirësuar kapacitetin operacional dhe gatishmërinë për ndërhyrje.

Sfida. Modernizimi i mëtejshëm i flotës dhe pajisjeve, reduktimi i kohës së reagimit në të gjithë territorin dhe forcimi i kapaciteteve për përballimin e zjarreve pyjore dhe emergjencave të lidhura me ndryshimet klimatike.

5. Menaxhimi i Mbetjeve

Rezultati. Është ruajtur **100% mbulimi i popullsisë** me shërbimin e menaxhimit të mbetjeve; gjatë vitit janë menaxhuar **32,023 ton mbetje**, ndërsa mbulimi i kostos së shërbimit nga tarifa arriti në **107.31%**.

Risia 2025. Krahazbatimit të Planit Vendor të Menaxhimit të Mbetjeve, është orientuar sektori drejt ekonomisë qarkulluese dhe reduktimit të plastikës përmes nismës ‘Elbasani Pa Plastikë’.

Sfida. Kalimi nga një sistem që garanton mbulim të plotë të shërbimit drejt një sistemi që rrit ndarjen në burim, riciklimin dhe reduktimin e mbetjeve të depozituara.

6. Mbrojtja Sociale

Rezultati. Performanca paraqitet pozitive, me zgjerim të aksesit në shërbimet sociale, strehimin social dhe mbështetjen për grupet në nevojë.

Risia 2025. Rrjeti i qendrave sociale komunitare është zgjeruar nga **9 në 11 qendra funksionale**. Paralelisht, është forcuar bashkëpunimi me **AKPA** për orientimin e familjeve përfituese të ndihmës ekonomike drejt masave aktive të punësimit.

Sfida. Zgjerimi i mëtejshëm i shërbimeve komunitare dhe **forcimi i kalimit nga skemat e mbështetjes sociale drejt përfshirjes sociale, punësimit dhe fuqizimit ekonomik të familjeve në nevojë.**

7. Infrastruktura dhe Shërbimet Publike

Rezultati. Performanca paraqitet përgjithësisht pozitive, me përmirësime në disa prej shërbimeve kryesore, veçanërisht në **ndriçimin publik**, si dhe me vijimësi në mirëmbajtjen e infrastrukturës dhe ofrimin e shërbimeve publike.

Risia 2025. Zgjerimi dhe modernizimi i rrjetit të ndriçimit publik përbën zhvillimin kryesor të vitit: rrjeti u zgjerua nga **121.5 km në 152.5 km (+25.51%)**, ndërsa numri i pikave funksionale u rrit nga **6,225 në 7,282 (+16.98%)**.

Sfida. Rehabilitimi i mëtejshëm i rrjetit rrugor dhe **modernizimi i transportit publik**, krahas zgjerimit të ndriçimit me eficiencë energjetike, sipërfaqeve të gjelbra dhe infrastrukturës sportive.

8. Burimet Njerëzore

Rezultati. Performanca paraqitet shumë pozitive, me **reduktim të ndjeshëm të rotacionit të stafit** dhe rritje të zhvillimit profesional të administratës.

Risia 2025. Numri i punonjësve të trajnuar u rrit nga **243 në 416**, ndërsa shkalla e rotacionit u reduktua nga **2.02% në 0.79%**, duke reflektuar një administratë më të qëndrueshme dhe investim më të lartë në zhvillimin profesional.

Sfida. Ruajtja e stabilitetit të administratës dhe kalimi drejt një sistemi më të digjitalizuar të menaxhimit të burimeve njerëzore dhe monitorimit të performancës.

9. Transparenca dhe Qeverisja e Hapur

Rezultati. Është garantuar konsultimi publik për **100% të akteve** për të cilat kjo procedurë kërkohej, është publikuar Raporti Vjetor i Transparencës dhe janë vijuar angazhimet në kuadër të **OGP Local**.

Risia 2025. Miratimi dhe fillimi i zbatimit të **Planit Vendor të Integritetit**, duke forcuar lidhjen ndërmjet transparencës, integritetit institucional dhe llogaridhënies.

Sfida. Rritja e mëtejshme e **pjesëmarrjes aktive dhe cilësore të qytetarëve** në proceset e konsultimit dhe vendimmarrjes, krahas zgjerimit të përdorimit të platformave digjitale dhe të dhënave të hapura.

10. Barazia Gjinore

Rezultati. Përfaqësimi i grave në pozicionet vendimmarrëse është rritur nga **36.49% në 38.36%**, ndërsa në pozicionet drejtuese të administratës nga **41.38% në 43.86%**.

Risia 2025. Është forcuar integrimi i **perspektivës gjinore** në planifikimin strategjik, monitorimin e performancës dhe politikat vendore, paralelisht me vijimin e zbatimit të **Planit Vendor të Veprimit për Barazinë Gjinore**.

Sfida. Rritja e mëtejshme e përfaqësimit të grave dhe integrimi më sistematik i **perspektivës gjinore** në **planifikimin, buxhetimin dhe monitorimin përmes treguesve të matshëm të performancës**.

11. Integrimi Evropian

Rezultati. Bashkia ka aplikuar në **12 projekte me financim të BE-së**, prej të cilave **9 janë fituar**, duke ruajtur një normë suksesi prej **75%**. Janë në zbatim **dy marrëveshje ndërbashkiake** dhe vijojnë të funksionojnë strukturat vendore të lidhura me integrimin evropian.

Risia 2025. Zgjerimi i bashkëpunimit ndërbashkiak dhe vijimi i pjesëmarrjes aktive në iniciativa evropiane në fushat e **klimes, inovacionit, qeverisjes së mirë dhe zhvillimit të qëndrueshëm**.

Sfida. Rritja e numrit dhe cilësisë së aplikimeve, forcimi i kapaciteteve për hartimin dhe menaxhimin e projekteve dhe **rritja e mëtejshme e përthithjes së fondeve të BE-së**, duke ruajtur një nivel të lartë suksesi në aplikime.

12. Menaxhimi Financiar

Rezultati. Performanca financiare paraqitet e qëndrueshme, me përmirësim të shkallës së ekzekutimit të buxhetit nga **71.79% në 74.45%** dhe të përdorimit të të ardhurave nga **86.65% në 88.67%**. Veçanërisht pozitiv është reduktimi i detyrimeve të papaguara nga **16.0 milionë lekë në 8.2 milionë lekë**.

Risia 2025. Forcimi i disiplinës financiare, i reflektuar në **reduktimin me rreth 49% të detyrimeve të papaguara**, paralelisht me ruajtjen e një niveli të konsiderueshëm të investimeve kapitale prej **550.8 milionë lekësh**.

Sfida. Rritja e autonomisë financiare përmes forcimit të të ardhurave të veta, përmirësimi i mëtejshëm i realizimit të buxhetit dhe ruajtja e një **balance të qëndrueshme ndërmjet shpenzimeve të personelit, shpenzimeve operacionale dhe investimeve kapitale**.

IV. VLERËSIM I PËRGJITHSHËM

Analiza e vitit 2025 evidenton se Bashkia Elbasan ka **konsoliduar më tej një qasje të orientuar drejt rezultateve dhe performancës**, duke përdorur tregues të matshëm për vlerësimin e funksioneve dhe shërbimeve vendore.

Panorama e përgjithshme evidenton tre zhvillime kryesore:

Së pari, janë konsoliduar standarde të rëndësishme të shërbimit, si **mirëmbajtja e plotë e infrastrukturës arsimore dhe mbulimi 100% i popullsisë me shërbimin e menaxhimit të mbetjeve**, krahas ruajtjes së qëndrueshmërisë në funksione të tjera vendore.

Së dyti, në disa sektorë janë shënuar zhvillime që forcojnë planifikimin dhe administrimin afatgjatë, përfshirë **Planin Vendor të Arsimit Parauniversitar, zgjerimin e mbulimit me Plane Vendore të Mbarështimit të pyjeve, miratimin e Planit Vendor të Integritetit, zgjerimin e rrjetit të shërbimeve sociale komunitare dhe orientimin më të fortë drejt ekonomisë qarkulluese**.

Së treti, sfida e fazës së ardhshme është jo vetëm ruajtja e rezultateve të arritura, por **rritja e cilësisë, eficiencës dhe qëndrueshmërisë së tyre**, përmes përshpejtimit të digjitalizimit, modernizimit të infrastrukturës dhe shërbimeve publike, rritjes së ndarjes në burim dhe riciklimit, forcimit të autonomisë financiare, përshtatjes ndaj ndryshimeve klimatike dhe përdorimit gjithnjë e më sistematik të treguesve të performancës në **planifikimin e politikave, priorizimin e investimeve dhe buxhetimin vendor**.

V. PËRFUNDIM

Raporti Vendor i Performancës 2025 i paraqitet Këshillit Bashkiak **për informim**, në funksion të transparencës dhe llogaridhënies mbi rezultatet e Bashkisë Elbasan gjatë vitit raportues.

Rezultatet e analizës tregojnë një performancë përgjithësisht **pozitive dhe të qëndrueshme**, ndërsa sfidat e identifikuara evidentojnë fushat ku duhet të përqendrohen më tej politikat, burimet dhe investimet e Bashkisë.

Në këtë kuptim, Raporti Vendor i Performancës duhet të shërbejë jo vetëm si dokument i raportimit vjetor, por edhe si **instrument pune për lidhjen e performancës me planifikimin, buxhetimin dhe vendimmarrjen e Bashkisë Elbasan**, duke mundësuar matjen e progresit nga viti në vit dhe orientimin e ndërhyrjeve drejt fushave ku të dhënat evidentojnë nevojën më të madhe.

Relacioni është përgatitur mbi bazën e të dhënave dhe vlerësimeve të përcjella nga strukturat përgjegjëse të Bashkisë Elbasan për secilën fushë të performancës, ndërsa koordinimi, konsolidimi dhe analiza e tyre në kuadër të Sistemit të Matjes së Performancës është realizuar nga struktura përgjegjëse për statistikën dhe performancën.

Këshilli Bashkiak ftohet të marrë dijeni mbi Raportin Vendor të Performancës së Bashkisë Elbasan për vitin 2025.


PËRGATITI DHE KOORDINOI:


Drejtoria e Politikave të Bujqësisë, Pyjeve, Mjedisit, Statistikave dhe Performancës
Lorena Haxhiymeri – Drejtore

KONTRIBUUAN DHE VERIFIKUAN TË DHËNAT PËR FUSHAT PËRKATËSE:

- Arsimi Parauniversitar E.Stafa
- Menaxhimi i Infrastrukturës së Ujitjes dhe Kullimit I Baho
- Administrimi i Pyjeve dhe Kullotave A.Muca
- Mbrojtja nga Zjarri dhe Shpëtimi E.Sota
- Menaxhimi i Mbetjeve A.Hajrullaj
- Mbrojtja Sociale M.Rexhepi
- Burimet Njerëzore M.Biba
- Transparenca dhe Qeverisja e Hapur L.Guri
- Barazia Gjinore M.Biba
- Integrimi Evropian A.Hodaj
- Menaxhimi Financiar A.Merkja

KRYETARI
Gledian Llafja





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ELBASAN

Nr. 4856 Prot.

Elbasan, më 31.08. 2026

RELACION

PËR MIRATIMIN E LISTËS EMËRORE TË SUBJEKTEVE QË KËRKOJNË TË NJIHEN SI “POSEDUES JOPRONARË”

Të nderuar Këshilltar!

Në mbështetje të ligjit nr. 20/2025 “Për paketën e maleve”; ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar; VKM nr. 625, datë 29.10.2025 “Për shpalljen e disa zonave me përparësi zhvillimin e ekonomisë malore në Bashkinë Elbasan” si dhe udhëzimit nr. 2, datë 15.10.2025 “Për përcaktimin e rregullave të hollësishme për dokumentacionin dhe procedurën e shpalljes së zonës prioritare të zhvillimit në territoret e Bashkive”. Bashkia Elbasan ka nxjerr urdhërin nr. 232, datë 30.03.2026 ‘Për ngritjen e grupit të punës me qëllim ndjekjen e procesit administrativ të kërkesave të subjekteve të ndryshëm kërkues, për tu njohur si Posedues Jopronarë’.

Në zbatim të urdhërit të sipërcituar Grupi i Punës kreu detyrat e poshtëcituara brenda afatit ligjor të caktuar në urdhër:

- Pas regjistrimit të kërkesës grupi i punës kryen verifikimin e dokumentacionit të paraqitur në çdo element të tij.
- Grupi i punës brenda 30 (*tridhjetë*) ditëve nga paraqitja e kërkesave nisi evidentimin në terren të sipërfaqeve, objekt të kërkesave të administruara, duke verifikuar gjendjen e posedimit të pasurisë nga subjektet, për të cilën mban procesverbalin përkatës.
- Grupi i punës përgatiti dhe dërgoi të gjithë korrespondencën e duhur me ASHK dhe ATP, ku kërkoi informacion sipas pikës 2 të nenit 7 të ligjit nr. 20/2025 “Për paketën e maleve”.
- Grupi i punës afishoi kërkesat për pasuritë apo pjesët të cilat përmbushnin kriteret, në ambientet e saj, në një mjedis tjetër publik (*Njësitë Administrative përkatëse*) brenda territorit të zonës dhe në faqen zyrtare të saj për një periudhë kohore prej 45 (dyzet e pesë) ditësh.

Pas përfundimit të afatit të njoftimit përmes afishimit publik, grupi i punës:

- Hartoi listat përfundimtare të subjekteve që kanë paraqitur kërkesë për njohje si posedues jopronarë, si dhe planin e rilevimit për sipërfaqet përkatëse;
- Po paraqet dokumentacionin përkatës për miratim pranë Këshillit Bashkiak, brenda 30 (*tridhjetë*) ditëve nga data e përfundimit të njoftimit publik për listat pjesore që kanë kaluar afatin 45 (dyzet e pesë) ditor;

Grupi i punës ka ndjekur me rigorozytet të gjithë hallkat ndërlidhëse të Udhëzimit nr. 1, datë 13.01.2026 “Për përcaktimin e rregullave të hollësishme për mënyrën e paraqitjes së aplikimit dhe procedurën administrative për njohjen si posedues jopronarë” të Bashkisë Elbasan.

Dhe nga grumbullimi, bashkëpunimi, analizimi dhe verifikimi në terren të pretenduesve që synojnë të shpallen posedues jopronar si dhe pas kalimit të afatit 45 (dyzet e pesë) ditë të afishimit publik për një pjesë të subjekteve, arriti në përfundimin që të propozoj për shpalljen si posedues jopronar listën emërore të pjesshme të shoqëruar me plan-rilevimet përkatëse sipas renditjes së mëposhtme:

➤ **Njësia Administrative Gjinar, Elbasan**

1. Anxhela Sinani

Anxhela Sinani ka paraqitur aplikimin nga e albania me nr **PM-2026-07049463719-KS** ku ka bashkangjitur dokumentet si Deklarata noteriale banorësh për posedimin, planvendosje nga topograf i licensuar, mandate pagesa taksash, vërtetim nga njësia administrative Gjinar dhe kryetari Fshatit Gjinar për mënyrën e posedimit. Me marrjen e aplikimit dhe shqyrtimit të dokumentacionit grupi i punës i dërgoi shkresë Atp dhe Ashk për marrje informacioni sipas nenit 7 të ligjit 20/2025 dhe pas marrjes së përgjigjes datë 16/04/2026 nga Ashk ku citon se pasuria pozicionohet në pasurinë nr 241 figuron pyll e rregjistruar në emër të Bashkisë Elbasan, ndërsa ATP me shkresë nr 2085/1 prot. datë 09/04/2026 thekson se nuk ka vendime për njohje kthim apo kompesim prone. Gjithashtu është kryer edhe verifikimi në terren nga grupi punës ku ka vërejtur që kjo pronë është e ruajtur nga familja e Anxhelës si dhe kjo sipërfaqe ndodhet ngjitur me banesën dhe pronat e familjes së saj. Pas kësaj është bërë edhe afishimi me datë 20/04/2026 dhe nuk ka pasur ankesa apo pretendime nga palë të treta.

Nisur sa më sipër plotësohen kriteret e lidhura me pronën sipas nenit 8 të ligjit 20/2025 “Për paketën e Maleve” dhe duhet të vijojnë procedurat e tjera për tu shpallur posedues jo pronar.

2. Viktor Qosja

Viktor Qosja ka paraqitur aplikimin nga e albania me nr **PM-2026-06022851626-HG** ku ka bashkangjitur dokumentet si planevendosje nga topograf i licensuar, foto, vërtetim nga njësia administrative Gjinar, kryetari Fshatit Gjinar për mënyrën e posedimit dhe projekt ide 3D. Me marrjen e aplikimit dhe shqyrtimit të dokumentacionit grupi i punës i dërgoi shkresë Atp dhe Ashk për marrje informacioni sipas nenit 7 të ligjit 20/2025 dhe pas marrjes së përgjigjes datë 31/03/2026 nga Ashk ku citon se pasuria pozicionohet në pasurinë nr.25 figuron kullotë e rregjistruar në emër të Bashkisë Elbasan, ndërsa ATP nr 1297/1 prot. datë 19/03/2026 thekson se nuk ka vendime për njohje kthim apo kompesim prone. Gjithashtu është kryer edhe verifikimi në terren nga grupi punës ku ka vërejtur që kjo kullotë e pastruar nga gurët pretendohet nga familja Qosja. Pas kësaj është bërë edhe afishimi me datë 20/04/2026 dhe nuk ka pasur ankesa apo pretendime nga palë të treta .

Nisur sa më sipër plotësohen kriteret e lidhura me pronën sipas nenit 8 të ligjit 20/2025 “Për paketën e Maleve” dhe duhet të vijojnë procedurat e tjera për tu shpallur posedues jo pronar.

3. Valbona Çullhaj

Valbona Çullhaj ka paraqitur aplikimin nga e albania me nr **PM-2026-08091658007-XY** ku ka bashkangjitur dokumentet si planevendosje nga topograf i licensuar, projekt ide si dhe një marrëveshje me avokat me datë 23/07/2015 midis saj edhe banorit i cili ka pasur një sipërfaqe toke por pa titull pronësie dhe kanë rënë në dakortësi që t'ja kalojë të drejtat e posedimit znj.Valbona. Me marrjen e aplikimit dhe shqyrtimit të dokumentacionit grupi i punës i dërgoi shkresë Atp dhe Ashk për marrje informacioni sipas nenit 7 të ligjit 20/2025 dhe pas marrjes së përgjigjes datë 04/05/2026 nga Ashk ku citon se pozicionohet në pasurinë nr 120/91/1 figuron pemtore shtet,ndërsa ATP me shkresë nr 2195/1 prot datë 16/04/2026 thekson se nuk ka vendime për njohje, kthim apo kompesim prone. Gjithashtu është kryer edhe verifikimi në terren nga grupi i punës ku ka vërejtur që kjo pronë është blerë para 11 vitesh nga znj.Valbona Çullhaj me avokat. Pas kësaj është bërë edhe afishimi me datë 27/04/2026 dhe nuk ka pasur ankesa apo pretendime nga palë të treta .

Nisur sa më sipër plotësohen kriteret e lidhura me pronën sipas nenit 8 të ligjit 20/2025 “Për paketën e Maleve” dhe duhet të vijojnë procedurat e tjera për tu shpallur posedues jo pronar.

4. Mark Karaj

Mark Karaj ka paraqitur aplikimin nga e albania me nr **PM-2026-10666539910-N5** ku ka bashkangjitur dokumentet si planvendosje nga topograf i licensuar, vërtetim nga kryesia e fshatit Gjinar, nga administratori i Njesisë, ortofoto si dhe deklaratë noteriale me datë01.05.2026. Me marrjen e aplikimit dhe shqyrtimit të dokumentacionit grupi i punës i dërgoi shkresë Atp dhe Ashk për marrje informacioni sipas nenit 7 të ligjit 20/2025 dhe pas marrjes së përgjigjes datë 22/05/2026 nga Ashk ku citon se pozicionohet në pasuritë nr 120/108 dhe 120/106 të cilat figurojnë të llojit shtet, ndërsa ATP me shkresë nr 2883/1 prot datë 14/05/2026 thekson se nuk ka vendime për njohje, kthim apo kompesim prone. Pas kësaj është bërë edhe afishimi me datë 18/06/2026 dhe nuk ka pasur ankesa apo pretendime nga palë të treta .

Nisur sa më sipër plotësohen kriteret e lidhura me pronën sipas nenit 8 të ligjit 20/2025 “Për paketën e Maleve” dhe duhet të vijojnë procedurat e tjera për tu shpallur posedues jo pronar.

5. Gjergji Ismaili

Gjergji Ismaili ka paraqitur aplikimin nga e albania me nr **PM-2026-07980064587-3W** ku ka bashkangjitur dokumentet si planvendosje nga topograf i licensuar, vërtetim nga kryesia e fshatit Gjinar, ortofoto si dhe deklaratë noteriale me datë01.05.2026. Me marrjen e aplikimit dhe shqyrtimit të dokumentacionit grupi i punës i dërgoi shkresë Atp dhe Ashk për marrje informacioni sipas nenit 7 të ligjit 20/2025 dhe pas marrjes së përgjigjes datë 30/04/2026 nga Ashk ku citon se pozicionohet në pasuritë nr 120/89 , 120/91 dhe 120/87/2 të cilat figurojnë të llojit shtet, si dhe ka cituar se pasuria pozicionohet pjesërisht mbi pasurinë nr. 120/92 në emër të Kozma Shqau, pas verifikimit u përgatit planvendosje e re nga ana e Bashkisë ku u la jashtë pjesa e cila mbivendosej,

ndërsa ATP me shkresë nr 2194/1 prot datë 16/04/2026 thekson se nuk ka vendime për njohje, kthim apo kompesim prone. Pas kësaj është bërë edhe afishimi me datë 23/06/2026 dhe nuk ka pasur ankesa apo pretendime nga palë të treta .

Nisur sa më sipër plotësohen kriteret e lidhura me pronën sipas nenit 8 të ligjit 20/2025 “Për paketën e Maleve” dhe duhet të vijojnë procedurat e tjera për tu shpallur posedues jo pronar.

➤ **Njësia Administrative Tregan, Elbasan**

1. Kreshnik Çela

Kreshnik Çela ka paraqitur aplikimin nga e albania me nr **PM-2026-287685-SA** ku ka bashkangjitur dokumentet si planvendosje nga topograf i licensuar, foto, deklarata dhe projekt arkitektonik. Me marrjen e aplikimit dhe shqyrtimit të dokumentacionit grupi i punës i dërgoi shkresë Atp dhe Ashk për marrje informacioni sipas nenit 7 të ligjit 20/2025 dhe pas marrjes së përgjigjes datë 01/04/2026 nga Ashk ku citon se pasuria pozicionohet në pasurinë nr 140/1/4 shtet e llojit truall, ndërsa ATP me shkresë nr 1297/1 prot datë 19/03/2026 thekson se nuk ka vendime për njohje kthim apo kompesim prone. Gjithashtu është kryer edhe verifikimi në terren nga grupi punës ku ka verejtur që kjo prone ndodhet rreth një ndërtese në pronësi të tijë dhe të familjarëve dhe është e rrethuar dhe mirëmbajtur në shërbim të biznesit. Pas kësaj është bërë edhe afishimi me datë 07/04/2026 dhe nuk ka pasur ankesa apo pretendime nga palë të treta .

Nisur sa më sipër plotësohen kriteret e lidhura me pronën sipas nenit 8 të ligjit 20/2025 “Për paketën e Maleve” dhe duhet të vijojnë procedurat e tjera për tu shpallur posedues jo pronar.

➤ **Njësia Administrative Funar, Elbasan**

1. Gjergj Likrama

Në kuadër të zbatimit të Memorandumit, Drejtoria e Politikave të Bujqësisë, Pyjeve, Mjedisit, Statistikave dhe Performancës do të jetë struktura përgjegjëse për koordinimin institucional dhe përmbajtësor, përfshirë koordinimin për identifikimin, shqyrtimin, përditësimin dhe validimin e dokumenteve, statistikave, raporteve dhe burimeve zyrtare të informacionit që do të përdoren në bazën e njohurive.

Për informacionet që u përkasin fushave të tjera të veprimtarisë së Bashkisë, drejtoritë dhe strukturat që prodhojnë, administrojnë ose disponojnë informacionin përkatës do të jenë përgjegjëse për verifikimin dhe konfirmimin e saktësisë, aktualitetit dhe burimit zyrtar të informacionit përpara përfshirjes së tij në bazën e njohurive.

Drejtoria e Teknologjisë së Informacionit dhe Medias do të jetë struktura përgjegjëse për koordinimin dhe miratimin teknik, për aspektet që lidhen me website-in zyrtar të Bashkisë, sigurinë dhe mënyrën e vendosjes dhe funksionimit të Asistentit Virtual në website.

Projekti “Bashki të Forta” do të mbulojë shpenzimet e pilotimit, përfshirë angazhimin e Entitetit Zbatues, konfigurimin dhe përshtatjen e Asistentit Virtual për nevojat e pilotit, vendosjen e tij në website-in zyrtar të Bashkisë, testimet e nevojshme, trajnimin e stafit dhe abonimin për një periudhë njëvjeçare.

Miratimi dhe zbatimi i Memorandumit nuk krijon detyrim financiar për Bashkinë Elbasan për pagesë, bashkëfinancim, rinovim automatik, blerje licence, abonim, mirëmbajtje apo vazhdim të shërbimit pas përfundimit të periudhës së financuar nga projekti “Bashki të Forta”. Çdo angazhim i mundshëm financiar i Bashkisë pas kësaj periudhe do të kërkojë një akt ose marrëveshje të veçantë, miratimin sipas kompetencave dhe respektimin e procedurave ligjore dhe buxhetore në fuqi.

Memorandumi përcakton gjithashtu kërkesat për mbrojtjen e të dhënave personale dhe konfidencialitetin, sigurinë dhe testimin e shërbimit, pronësinë dhe kontrollin e Bashkisë mbi dokumentet dhe materialet e saj, mbështetjen teknike, trajtimin e incidenteve, monitorimin, trajnimin e stafit, si dhe kushtet për pezullimin dhe ndërprerjen e përdorimit të Asistentit Virtual.

Dokumentet, të dhënat burimore, marka, logoja dhe informacioni institucional i Bashkisë mbeten pronë ose nën kontrollin e Bashkisë. Në përfundim të përdorimit të shërbimit, Bashkia ka të drejtë të marrë ose shkarkojë dokumentet dhe materialet e veta të përdorura në kuadër të Asistentit Virtual, sipas kushteve të përcaktuara në Memorandum.

Në rast se, pas përfundimit të periudhës së financuar, Bashkia vendos të mos vazhdojë përdorimin e shërbimit, kjo nuk përbën shkelje dhe nuk sjell penaltet apo pretendim kompensimi ndaj Bashkisë. Asistenti Virtual hiqet ose çaktivizohet nga website-i zyrtar dhe Bashkisë i lihet afati i parashikuar në Memorandum për shkarkimin e dokumenteve dhe materialeve të veta.

Kushtet konkrete teknike dhe operative për vendosjen, përdorimin dhe funksionimin e shërbimit, për aq sa do të jetë e nevojshme, mund të detajohen në Aneksin – Kushtet e Përdorimit të Shërbimit, pa ndryshuar objektin e Memorandumit dhe pa krijuar angazhime institucionale, financiare ose juridike shtesë për Palët.

Baza ligjore për këtë bashkëpunim mbështetet në ligjin nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar; ligjin nr. 114/2024 për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Konfederatës Zvicerane për projektin “Bashki të Forta (BtF), Faza 2”; ligjin nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, i ndryshuar; ligjin nr. 124/2024 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”; ligjin nr. 25/2024 “Për sigurinë kibernetike”, në masën që është i zbatueshëm; si dhe Memorandumin e Bashkëpunimit nr. 502 prot., datë 24.01.2023, ndërmjet Bashkisë Elbasan dhe projektit “Bashki të Forta”.

Në vlerësim të sa më sipër, duke konsideruar se realizimi i këtij projekti pilot kontribuon në përmirësimin e aksesit të qytetarëve në informacion, transparencën, llogaridhënien dhe komunikimin institucional, i propozohet Këshillit Bashkiak Elbasan miratimi i Memorandumit të Mirëkuptimit ndërmjet Bashkisë Elbasan dhe projektit “Bashki të Forta” (BtF), të zbatuar nga Helvetas Swiss Intercooperation, sipas tekstit bashkëlidhur projektvendimit.

Konceptoi: DPBPMSP L.Haxhiymeri

Drejt Tek.Infor. O.Gega.

Drejt Juridike E.Arapi

KRYETAR

Gledian LIATJA

BASHKIA ELBASAN



HELVETAS SWISS INTERCOOPERATION

Projekti “Bashki të Forta”



Nr. _____ prot.

Elbasan, më ____ . ____ . 2026

Nr. _____ prot.

Tiranë, më ____ . ____ . 2026

MEMORANDUM MIRËKUPTIMI

MIDIS

BASHKISË ELBASAN

DHE

PROJEKTIT “BASHKI TË FORTA” (BtF), TË ZBATUAR NGA HELVETAS SWISS INTERCOOPERATION

“Për mbështetjen e projektit pilot për konfigurimin, vendosjen dhe përdorimin e Asistentit Virtual (Chatbot) me Inteligjencë Artificiale për rritjen e transparencës, llogaridhënies dhe informimit të qytetarëve në website-in zyrtar të Bashkisë Elbasan”

Ky Memorandum Mirëkuptimi lidhet ndërmjet Bashkisë Elbasan, e përfaqësuar nga Kryetari i Bashkisë, z. Gledian Llatja, me adresë Rruga “11 Nëntori”, Elbasan, në vijim “Bashkia”,

dhe

Projektit “Bashki të Forta” (BtF), projekt i Agjencisë Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC) dhe i Qeverisë së Suedisë, i zbatuar nga Helvetas Swiss Intercooperation (Helvetas), i përfaqësuar nga Norbert Pijls, Drejtor i Programit, në vijim “BtF”.

Bashkia dhe BtF referohen veçmas si “Palë” dhe së bashku si “Palët”.

BAZA LIGJORE

Ky Memorandum mbështetet në Ligjin nr. 114/2024 për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Konfederatës Zvicerane për projektin “Bashki të Forta (BtF), Faza 2”; Ligjin nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar; Ligjin nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”; Ligjin nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”; Ligjin nr. 124/2024 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”; Ligjin nr. 25/2024 “Për sigurinë kibernetike”, në masën që është i aplikueshëm; aktet nënligjore dhe rregulloret e zbatueshme të Bashkisë dhe Këshillit Bashkiak; si dhe Memorandumin e Bashkëpunimit nr. 502 prot., datë 24.01.2023, ndërmjet Bashkisë Elbasan dhe BtF.

PREAMBULË

Duke marrë në konsideratë angazhimin e Bashkisë Elbasan për rritjen e transparencës, llogaridhënies, aksesit në informacion dhe përmirësimin e komunikimit me qytetarët;

Duke vlerësuar mundësitë që ofron përdorimi i përgjegjshëm i Inteligjencës Artificiale për lehtësimin e aksesit në informacionin publik dhe shërbimet e Bashkisë;

Duke marrë në konsideratë mbështetjen e projektit “Bashki të Forta” për forcimin e kapaciteteve dhe qeverisjes vendore;

Duke njohur nevojën që çdo zgjidhje e Inteligjencës Artificiale e vendosur në website-in zyrtar të Bashkisë të zbatohet me standarde të përshtatshme sigurie, privatësie, transparence, kontrolli institucional dhe mbrojtjeje të interesit publik;

Duke vlerësuar rëndësinë e një pilotimi të kontrolluar, testimit, validimit dhe trajnimit të stafit përpara dhe gjatë përdorimit të Asistentit Virtual;

Palët bien dakord si më poshtë:

NENI 1

QËLLIMI I MEMORANDUMIT

Qëllimi i këtij Memorandumi është formalizimi i bashkëpunimit ndërmjet Palëve për , konfigurimin, testimin, integrimin dhe pilotimin e një Agjenti Dixhital (Chatbot) me Inteligjencë Artificiale në faqen zyrtare të Bashkisë Elbasan.

1. Agjenti Dixhital synon të rrisë transparencën, llogaridhënien dhe aksesin e qytetarëve në informacionin zyrtar mbi performancën, shërbimet dhe veprimtarinë e Bashkisë.
2. Baza e njohurive ndërtohet mbi dokumente, të dhëna dhe burime zyrtare të miratuara nga Bashkia.
3. Agjenti ka karakter informues dhe nuk zëvendëson aktet administrative, përgjigjet zyrtare, procedurat ligjore, kërkesat për informacion, të drejtën e ankimit apo komunikimin me punonjësit përgjegjës.
4. Pilotimi synon gjithashtu të krijojë një model të dokumentuar dhe të vlerësueshëm për përdorim të mëtejshëm, pa cenuar të drejtat dhe interesat institucionale të Bashkisë.

NENI 2

ANGAZHIMET E BASHKISË ELBASAN

1. Të vendosë në dispozicion, për qëllime të pilotimit, dokumentet, të dhënat dhe burimet zyrtare të informacionit, të nevojshme dhe të miratuara për përfshirje në bazën e njohurive të Asistentit Virtual.
2. Të marrë pjesë në workshop-in e përbashkët për përcaktimin, shqyrtimin dhe validimin e skenarëve të pyetjeve dhe përgjigjeve të Asistentit Virtual.
3. Të caktojë Drejtorinë e Teknologjisë së Informacionit dhe Medias si strukturën përgjegjëse për koordinimin dhe miratimin teknik të projektit, për aspektet që lidhen me website-in zyrtar të Bashkisë, sigurinë dhe mënyrën e vendosjes dhe funksionimit të Asistentit Virtual në website.
4. Të caktojë Drejtorinë e Politikave të Bujqësisë, Pyjeve, Mjedisit, Statistikave dhe Performancës si strukturën përgjegjëse për koordinimin institucional dhe përmbajtësor, përfshirë identifikimin dhe koordinimin për vënien në dispozicion të dokumenteve, statistikave, raporteve dhe burimeve zyrtare të informacionit që do të përfshihen në bazën e njohurive, si dhe

koordinimin e procesit të shqyrtimit, përditësimit dhe validimit të përmbajtjes me strukturat përkatëse të Bashkisë.

5. Për informacionet që lidhen me fusha të tjera të veprimtarisë së Bashkisë, drejtoritë dhe strukturat përgjegjëse që prodhojnë, administrojnë ose disponojnë informacionin përkatës janë përgjegjëse për verifikimin dhe konfirmimin e saktësisë, aktualitetit dhe burimit zyrtar të tij, përpara përfshirjes në bazën e njohurive. Drejtoria e Politikave të Bujqësisë, Pyjeve, Mjedisit, Statistikave dhe Performancës koordinon këtë proces me strukturat përkatëse.

6. Të bashkëpunojë në testimin dhe validimin funksional të Asistentit Virtual dhe të kërkojë, sipas rastit, korrigjimin, përditësimin, heqjen ose çaktivizimin e përmbajtjeve apo funksionaliteteve të pasakta, të vjetruara, të pasigurta ose jashtë qëllimit të përcaktuar të pilotit.

7. Për ofrimin e shërbimit, Entitetit Zbatues nuk i jepet akses në sistemet e brendshme, bazat e të dhënave, kredencialet administrative apo infrastrukturën e brendshme teknologjike të Bashkisë. Vendosja e Asistentit Virtual në website-in zyrtar realizohet vetëm nëpërmjet mënyrës teknike të dakordësuar dhe të miratuar nga Drejtoria e Teknologjisë së Informacionit dhe Medias.

8. Të sigurojë, brenda kapaciteteve institucionale, pjesëmarrjen e stafit përkatës në trajnimet, testimet dhe aktivitetet e tjera të parashikuara në kuadër të pilotimit.

9. Bashkia Elbasan nuk ka detyrim të vendosë në dispozicion të dhëna personale, informacione konfidenciale ose të klasifikuara, kredenciale aksesit, baza të brendshme të të dhënave apo informacione të tjera që nuk janë të nevojshme për realizimin e qëllimit të pilotit. Çdo përpunim i të dhënave personale, kur rezulton i nevojshëm, kryhet vetëm në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe me dispozitat përkatëse të këtij Memorandumi.

10. Të sigurojë, brenda kapaciteteve dhe mundësive institucionale të Bashkisë, burimet njerëzore dhe organizative të nevojshme për përfaqësuesit e saj të angazhuar në realizimin e detyrave funksionale që lidhen me zbatimin e projektit pilot.

NENI 3

ANGAZHIMET E PROJEKTIT “BASHKI TË FORTA”

1. Të mbulojë shpenzimet e pilotimit, përfshirë angazhimin e Entitetit Zbatues, konfigurimin dhe përshtatjen e Asistentit Virtual për nevojat e pilotit, vendosjen e tij në website-in zyrtar të Bashkisë, testimet e nevojshme, trajnimin e stafit dhe abonimin për një periudhë njëvjeçare.

2. Të sigurojë përgatitjen dhe konfigurimin e bazës së njohurive mbi dokumentet dhe burimet e miratuara nga Bashkia, si dhe konfigurimin fillestar të Asistentit Virtual për përdorimin e kësaj baze njohurish.
3. Të identifikojë dhe t'i paraqesë Bashkisë, përpara vënies në funksionim të shërbimit, Entitetin Zbatues dhe informacionin e nevojshëm mbi shërbimin, platformën dhe kushtet përkatëse të përdorimit të tij, në masën që këto informacione janë relevante për Bashkinë dhe për përmbushjen e kërkesave ligjore të zbatueshme.
4. Të sigurojë bashkëpunimin e Entitetit Zbatues me strukturat përgjegjëse të Bashkisë për realizimin e pilotit. Kushtet teknike dhe operative për vendosjen dhe përdorimin e shërbimit në website-in zyrtar të Bashkisë mund të detajohen më tej në një Aneks – Kushtet e Përdorimit të Shërbimit, në përputhje me parimet e përcaktuara në këtë Memorandum.
5. Të vendosë në dispozicion të Bashkisë informacionin e nevojshëm për përdorimin dhe administrimin e shërbimit nga ana e Bashkisë, përfshirë kushtet e përdorimit, kufizimet përkatëse dhe kostot e mundshme të vazhdimit të shërbimit pas përfundimit të periudhës së financuar.
6. Të sigurojë, nëpërmjet Entitetit Zbatues, mbështetjen teknike të nevojshme gjatë periudhës së pilotimit dhe abonimit, në përputhje me natyrën dhe kushtet e shërbimit, si dhe bashkëpunimin për çështjet që lidhen me sigurinë, privatësinë, funksionimin dhe përfundimin e përdorimit të shërbimit.

NENI 4

VENDOSJA TEKNIKE, AKSESI DHE FUNKSIONIMI I SHËRBIMIT

1. Asistenti Virtual ofrohet si një shërbim ekzistues me abonim dhe nuk përbën zhvillim të një sistemi apo programi informatik të posaçëm për Bashkinë Elbasan.
2. Vendosja dhe shfaqja e Asistentit Virtual në website-in zyrtar të Bashkisë realizohet me asistencën teknike të Entitetit Zbatues dhe me miratimin e Drejtorisë së Teknologjisë së Informacionit dhe Medias, sipas mënyrës teknike të përcaktuar për ofrimin e shërbimit.
3. Ofrimi i shërbimit nuk kërkon që Entiteti Zbatues të ketë akses në sistemet e brendshme, CMS-në, bazat e të dhënave, kredencialet administrative apo infrastrukturën e brendshme teknologjike të Bashkisë.

4. Çdo veprim që duhet të kryhet në website-in ose mjedisin teknologjik të administruar nga Bashkia realizohet nga Drejtoria e Teknologjisë së Informacionit dhe Medias ose nën kontrollin dhe miratimin e saj.
5. Përpara vënies në funksionim, Entiteti Zbatues i vë në dispozicion Bashkisë informacionin e nevojshëm për mënyrën e përdorimit dhe funksionimit të shërbimit dhe për mënyrën teknike të vendosjes së tij në website, në masën që ky informacion është i zbatueshëm për shërbimin e ofruar.
6. Ndryshimet në mënyrën e ofrimit ose konfigurimit të shërbimit që ndikojnë drejtpërdrejt në website-in, sigurinë, privatësinë, të dhënat, kostot ose funksionimin e shërbimit për Bashkinë i komunikohen paraprakisht Bashkisë dhe, kur kërkojnë ndërhyrje në website-in e saj, realizohen vetëm pas miratimit të Drejtorisë së Teknologjisë së Informacionit dhe Medias.
7. Kushtet konkrete teknike dhe operative të përdorimit të shërbimit, për aq sa është e nevojshme, mund të përcaktohen më tej në Aneksin – Kushtet e Përdorimit të Shërbimit.

NENI 5

MBROJTJA E TË DHËNAVE PERSONALE DHE KONFIDENCIALITETI

1. Palët respektojnë Ligjin nr. 124/2024 “Për mbrojtjen e të dhënave personale” dhe legjislacionin tjetër të zbatueshëm.
2. Përpara çdo përpunimi të të dhënave personale përcaktohen, sipas rastit dhe në masën e kërkuar nga legjislacioni, rolet ligjore të palëve, qëllimet, kategoritë e të dhënave, afatet e ruajtjes dhe masat e sigurisë; kur kërkohet, lidhet Marrëveshje për Përpunimin e të Dhënave (DPA) dhe/ose Marrëveshje Konfidencialiteti (NDA).
3. Baza e njohurive ndërtohet, si rregull, nga dokumente publike ose të miratuara për publikim. Përfshirja e të dhënave personale kërkon bazë ligjore, nevojë të dokumentuar dhe miratim të Bashkisë.
4. Të dhënat që mund të gjenerohen gjatë përdorimit të shërbimit, përfshirë historikun e bisedave, log-et ose metadata, nëse ruhen nga shërbimi, trajtohen në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe kushtet e përdorimit të shërbimit.
5. Dokumentet dhe materialet e Bashkisë të vendosura në dispozicion për bazën e njohurive nuk përdoren për qëllime të tjera jashtë ofrimit të shërbimit të parashikuar nga ky Memorandum, pa bazë ligjore dhe pa miratimin përkatës të Bashkisë.

6. Çdo përpunim ose transferim i të dhënave personale kryhet në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi.
7. Në përfundim të marrëdhënies, dokumentet, materialet dhe të dhënat e Bashkisë trajtohen sipas kushteve të përcaktuara në këtë Memorandum, Aneksin – Kushtet e Përdorimit të Shërbimit dhe legjislacionin në fuqi.
8. Detyrimet e konfidencialitetit mbeten në fuqi edhe pas përfundimit ose ndërprerjes së Memorandumit, në masën e parashikuar nga ligji.

NENI 6

KËRKESAT PËR AGJENTIN DIXHITAL ME INTELIGJENCË ARTIFICIALE

1. Agjenti identifikohet qartë për qytetarin si sistem automatik me Inteligjencë Artificiale dhe jo si punonjës i Bashkisë.
2. Përgjigjet kanë karakter informativ dhe nuk përbëjnë akt administrativ, vendim, interpretim ligjor detyrues ose përgjigje zyrtare individuale.
3. Përgjigjet bazohen në bazën e njohurive të miratuar. Kur informacioni mungon, është i paqartë ose kërkon vlerësim individual, Agjenti nuk duhet të improvizojë dhe e orienton përdoruesin te kanali zyrtar ose te një punonjës.
4. Për çështje ligjore, ankesa, kërkesa individuale, të dhëna personale, emergjenca ose raste jashtë fushës parashikohet mekanizëm eskalimi te njeriu/shërbimi zyrtar përkatës.
5. Kur është teknikisht e mundur, përgjigjet shoqërohen me burimin zyrtar, linkun, titullin ose referencën e dokumentit.
6. Zbatohen masa kundër prompt injection, nxjerrjes së informacionit të sistemit, keqpërdorimit, përmbajtjes së papërshtatshme dhe manipulimit të bazës së njohurive.
7. Ndryshimi i modelit IA, ofruesit, hosting-ut ose nën-përpunuesve që prek riskun, privatësinë, sigurinë ose funksionimin kërkon miratim paraprak të Bashkisë.

NENI 7

SIGURIA, TESTIMI DHE VËNIA NË FUNKSIONIM

1. Vendosja dhe përdorimi i shërbimit në website-in zyrtar të Bashkisë kryhen në përputhje me legjislacionin e zbatueshëm për sigurinë kibernetike dhe kërkesat e tjera ligjore përkatëse, në masën që janë të aplikueshme për natyrën e shërbimit.
2. Për ofrimin e shërbimit zbatohen masa të përshtatshme teknike dhe organizative për sigurinë dhe mbrojtjen e informacionit, në përputhje me natyrën dhe nivelin e riskut të shërbimit.
3. Përpara vënies në funksionim në website-in zyrtar të Bashkisë kryhen verifikimet dhe testimet e nevojshme lidhur me mënyrën e vendosjes dhe funksionimit të Asistentit Virtual në website.
4. Entiteti Zbatues bashkëpunon me Drejtorinë e Teknologjisë së Informacionit dhe Medias për çdo verifikim teknik që lidhet drejtpërdrejt me vendosjen dhe funksionimin e shërbimit në website-in zyrtar të Bashkisë.
5. Vënia në funksionim e shërbimit në website-in zyrtar të Bashkisë kryhet pas përfundimit të verifikimeve teknike përkatëse dhe konfirmimit teknik nga Drejtoria e Teknologjisë së Informacionit dhe Medias, si dhe pas validimit të përmbajtjes nga struktura përgjegjëse e Bashkisë.
6. Vendosja dhe vënia në funksionim e Asistentit Virtual në website-in zyrtar të Bashkisë Elbasan planifikohet për periudhën 7–11 shtator 2026. Ky afat konsiderohet indikativ dhe mund të përshtatet në varësi të përfundimit të konfigurimit, verifikimeve teknike, kërkesave për mbrojtjen e të dhënave dhe validimit të përmbajtjes.
7. Kushtet dhe procedurat teknike që lidhen me vendosjen dhe funksionimin e shërbimit mund të detajohen më tej, sipas nevojës, në Aneksin – Kushtet e Përdorimit të Shërbimit.

NENI 8

PRONËSIA, LICENCAT DHE MATERIALET E BASHKISË

1. Dokumentet, të dhënat burimore, marka, logoja dhe informacioni institucional i Bashkisë mbeten pronë ose nën kontrollin e Bashkisë.
2. Asistenti Virtual ofrohet si shërbim ekzistues me abonim. Ky Memorandum nuk transferon te Bashkia pronësinë mbi platformën, programin, kodin, modelet, teknologjitë apo komponentët ekzistues të Entitetit Zbatues ose të palëve të treta.

3. Dokumentet dhe materialet e Bashkisë të përdorura për krijimin dhe konfigurimin e bazës së njohurive mbeten nën kontrollin e Bashkisë dhe përdoren vetëm për qëllimet e përcaktuara në këtë Memorandum.
4. Bashkisë i bëhen të njohura kushtet kryesore të përdorimit të shërbimit, kufizimet përkatëse dhe kushtet financiare të mundshme për vazhdimin e tij pas përfundimit të periudhës së financuar nga BtF.
5. Entiteti Zbatues i vendos Bashkisë në dispozicion informacionin dhe udhëzimet e nevojshme për përdorimin dhe administrimin e funksionaliteteve që i vihen në dispozicion Bashkisë në kuadër të shërbimit.
6. Në përfundim të përdorimit të shërbimit, Bashkia ka të drejtë të marrë ose shkarkojë dokumentet dhe materialet e veta të përdorura në kuadër të Asistentit Virtual, në formatin dhe mënyrën që mundëson shërbimi.
7. Akses i përdorimit të Asistentit Virtual nga Bashkia Elbasan përfundon në momentin e përfundimit të këtij Memorandumi ose të abonimit përkatës. Bashkia Elbasan do të ketë 30 ditë kohë shtesë nga përfundimi i shërbimit për të shkarkuar dokumentet dhe materialet e veta të përdorura nga Asistenti Virtual, sipas kushteve të shërbimit.

NENI 9

NIVELI I SHËRBIMIT, MBËSHTETJA TEKNIKE DHE INCIDENTET

1. Përpara vënies në funksionim të shërbimit, Bashkisë i vihet në dispozicion informacioni i nevojshëm mbi mënyrën e ofritit të mbështetjes teknike dhe trajtimit të problematikave që mund të lindin gjatë përdorimit të shërbimit.
2. Në rast të një defekti ose incidenti që ndikon në disponueshmërinë, funksionimin ose sigurinë e shërbimit për Bashkinë, Entiteti Zbatues bashkëpunon me strukturat përgjegjëse të Bashkisë për identifikimin dhe trajtimin e tij, sipas natyrës së problematikës dhe kushteve të shërbimit.
3. Ndërprerjet e planifikuara të shërbimit që mund të ndikojnë në funksionimin e Asistentit Virtual në website-in e Bashkisë njoftohen paraprakisht, ndërsa incidentet e paplanifikuara që kanë ndikim të drejtpërdrejtë në shërbimin e Bashkisë komunikohen pa vonesë.

4. Çdo incident sigurie ose cenim i të dhënave që prek ose mund të ndikojë në të dhënat ose materialet e Bashkisë i komunikohet pa vonesë Drejtorisë së Teknologjisë së Informacionit dhe Medias, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe procedurat e zbatueshme.
5. Çdo komunikim publik lidhur me një incident sigurie, cenim të të dhënave ose keqfunksionim të shërbimit që prek Bashkinë Elbasan koordinohet paraprakisht ndërmjet Palëve, përveç rasteve kur komunikimi kërkohet nga legjislacioni në fuqi ose nga autoriteti kompetent.
6. Procedurat operative për raportimin dhe menaxhimin e problematikave dhe incidenteve, kanalet e komunikimit dhe mbështetja teknike mund të detajohen më tej në Aneksin – Kushtet e Përdorimit të Shërbimit.

NENI 10

ASPEKTET FINANCIARE DHE VAZHDIMËSIA

1. Shpenzimet e pilotimit dhe abonimit njëvjeçar të Asistentit Virtual mbulohen nga BtF sipas këtij Memorandumi.
2. Ky Memorandum nuk krijon detyrim për Bashkinë për pagesë, bashkëfinancim, rinovim automatik, blerje licence, abonim, mirëmbajtje apo vazhdim të shërbimit pas periudhës së financuar.
3. Çdo angazhim financiar i ardhshëm i Bashkisë kërkon një akt ose marrëveshje të veçantë, miratim sipas kompetencave dhe respektimin e procedurave ligjore e buxhetore.
4. Jo më vonë se tre muaj përpara përfundimit të abonimit të financuar, BtF i komunikon Bashkisë kostot dhe kushtet e mundshme të vazhdimit të shërbimit dhe Palët zhvillojnë një vlerësim të performancës dhe nevojës për vijim.
5. Nëse Bashkia vendos të mos vazhdojë shërbimin, kjo nuk konsiderohet shkelje dhe nuk sjell penalitet ose pretendim kompensimi ndaj saj.
6. Në momentin e përfundimit të abonimit dhe në rast mosvazhdimi të këtij shërbimi, Asistenti Virtual nuk do të shfaqet më në website-in e Bashkisë dhe Bashkia do të ketë 30 ditë kohë për shkarkimin e dokumenteve dhe materialeve të veta të përdorura në kuadër të shërbimit.

NENI 11

MONITORIMI DHE KOORDINIMI

1. Palët ndjekin zbatimin e Memorandumit përmes komunikimit periodik, takimeve koordinuese dhe shkëmbimit të informacionit të nevojshëm.
2. Helvetas, SDC ose një palë e tretë e autorizuar prej tyre mund të monitorojë zbatimin e projektit brenda qëllimit të këtij Memorandumi, duke respektuar konfidencialitetin, sigurinë, mbrojtjen e të dhënave dhe kufizimin e aksesit në informacionin e nevojshëm.
3. Bashkia, nëpërmjet **Drejtorisë së Teknologjisë së Informacionit dhe Medias** dhe strukturave të autorizuar, ka të drejtë të monitorojë dhe auditojë aspektet teknike, të sigurisë, përdorimit të të dhënave dhe performancës që lidhen me sistemet dhe interesat e saj.
4. Palët mund të krijojnë grup pune ose mekanizëm koordinues për zbatimin e pilotit.
5. **Për koordinimin e zbatimit të këtij Memorandumi, Bashkia Elbasan cakton si persona kontakti:**

a) **znj. Lorena Haxhiymeri**, Drejtore e Politikave të Bujqësisë, Pyjeve, Mjedisit, Statistikave dhe Performancës, për koordinimin institucional dhe përmbajtësor;

b) **z. Olsi Gega**, **Drejtor i Teknologjisë së Informacionit dhe Medias**, për koordinimin teknik, sigurinë, akseset dhe integrimin e Agjentit Dixhital. Drejtoria e Teknologjisë së Informacionit dhe Medias cakton gjithashtu **një person zëvendësues për kontaktin teknik**, i cili ushtron këtë funksion në mungesë të personit të kontaktit teknik.

Personat e kontaktit veprojnë brenda kompetencave të strukturave që përfaqësojnë dhe caktimi i tyre nuk transferon tek ata përgjegjësitë që u përkasin strukturave të tjera të Bashkisë.

6. Ndryshimi i personave të kontaktit bëhet me njoftim me shkrim dhe nuk kërkon ndryshim të Memorandumit.

NENI 12

PËRGJEGJËSITË E PALËVE

1. Palët bashkëpunojnë në mirëbesim dhe në mënyrë të barabartë për realizimin e qëllimit të këtij Memorandumi, duke ushtruar secila përgjegjësitë dhe angazhimet e veta në përputhje me këtë Memorandum dhe legjislacionin në fuqi.

2. Përgjegjësitë teknike dhe operative që lidhen me vendosjen dhe funksionimin e shërbimit në website-in e Bashkisë, konfigurimin e shërbimit për qëllimet e pilotit, sigurinë, mbrojtjen e të dhënave, testimin, mbështetjen teknike dhe administrimin e funksionaliteteve që i vihen në dispozicion Bashkisë mund të përcaktohen më tej në Aneksin – Kushtet e Përdorimit të Shërbimit, në përputhje me parimet dhe kërkesat e përcaktuara në këtë Memorandum dhe legjislacionin në fuqi.
3. Secila Palë njofton pa vonesë Palën tjetër për çdo rrethanë që mund të ndikojë në realizimin e projektit pilot dhe bashkëpunon për marrjen e masave të nevojshme për trajtimin e saj.
4. Asnjë përgjigje e gjeneruar nga Asistenti Virtual nuk krijon vetvetiu detyrim financiar, administrativ ose ligjor për Bashkinë Elbasan dhe nuk zëvendëson aktet, procedurat apo komunikimet zyrtare të Bashkisë

NENI 13

PËRDORIMI I EMRIT, LOGOS DHE IDENTITETIT INSTITUCIONAL

1. Asnjë Palë nuk përdor emrin, logon, stemën, vulën ose identitetin institucional të Palës tjetër në materiale promovuese, publikime apo komunikime që mund të interpretohen si miratim institucional i një produkti/ofruesi pa miratim paraprak me shkrim.
2. Komunikimi institucional i dakordësuar për projektin, donatorët dhe rezultatet e pilotit realizohet sipas rregullave të identitetit dhe komunikimit të Palëve.

NENI 14

KOHËZGJATJA, PEZULLIMI DHE NDËRPRERJA

1. Ky Memorandum hyn në fuqi pas **miratimit nga Këshilli Bashkiak i Bashkisë Elbasan dhe nënshkrimit nga të dyja Palët** dhe zbatohet për periudhën e pilotimit dhe të abonimit njëvjeçar të financuar nga projekti “Bashki të Forta” (BtF), përveç detyrimeve të cilat, për nga natyra e tyre, vazhdojnë të zbatohen edhe pas përfundimit ose ndërprerjes së Memorandumit.
2. Bashkia ka të drejtë të pezullojë menjëherë aksesin ose funksionimin e Agjentit kur konstatohet ose dyshohet në mënyrë të arsyeshme rrezik sigurie, shkelje e të dhënave, keqfunksionim serioz, përmbajtje që mund të dëmtojë qytetarët/interesi publik ose mospërputhje me këtë Memorandum.

3. Në rast urgjence sigurie, pezullimi mund të kryhet pa njoftim paraprak, me njoftim të menjëhershëm të BtF pas veprimit.
4. Secila Palë mund të kërkojë ndërprerjen për shkelje thelbësore, forcë madhore, pamundësi ligjore/teknike ose arsye të tjera të justifikuara, pas njoftimit me shkrim dhe, kur është e mundur, dhënies së një afati të arsyeshëm për korrigjim.
5. Ndërprerja nuk cenon detyrimet për konfidencialitetin, mbrojtjen e të dhënave, dorëzimin/fshirjen, revokimin e aksesit dhe përgjegjësitë e lindura.
6. Përfundimi i periudhës së pilotimit ose vendimi i Bashkisë Elbasan për të mos vijuar përdorimin e Agjentit Dixhital pas përfundimit të periudhës së financuar nga BtF nuk krijon detyrim financiar, penalitet, detyrim për rinovim të shërbimit apo të drejtë kompensimi ndaj Bashkisë Elbasan. Në këtë rast zbatohen procedurat e dorëzimit dhe eksportimit të materialeve dhe të dhënave, revokimit të aksesit, fshirjes së të dhënave dhe çaktivizimit të sigurt të integritetit, sipas këtij Memorandumi.

NENI 15

TRAJNIMI DHE TRANSFERIMI I NJOHURIVE

1. BtF/Entiteti Zbatues siguron trajnimin e përgjithshëm të stafit për përdorimin e Asistentit Virtual dhe të funksionaliteteve që i vihen në dispozicion Bashkisë.
2. Drejtoria e Teknologjisë së Informacionit dhe Medias trajnohet, sipas nevojës, për aspektet teknike që lidhen me funksionimin e Asistentit Virtual në website-in e Bashkisë, administrimin e aksesit që i vihet në dispozicion Bashkisë, monitorimin e funksionimit dhe procedurat për raportimin e problematikave teknike.
3. Strukturat përgjegjëse për përmbajtjen trajnohen për administrimin dhe përditësimin e bazës së njohurive, validimin e informacionit dhe menaxhimin e rasteve që kërkojnë orientimin e përdoruesit drejt kanaleve zyrtare të Bashkisë.


NENI 16

DISPOZITA PËRFUNDIMTARE

1. Ky Memorandum shpreh kuadrin e bashkëpunimit institucional ndërmjet Palëve për realizimin e projektit pilot dhe nuk interpretohet si kontratë tregtare apo si autorizim për krijimin e detyrimeve financiare të Bashkisë përtej atyre që miratohen shprehimisht sipas legjislacionit në fuqi.

2. Çdo ndryshim ose shtesë në këtë Memorandum është e vlefshme vetëm nëse bëhet me shkrim dhe miratohet/nënshkruhet nga të dyja Palët. Çështjet teknike dhe operative që nuk ndryshojnë objektin, angazhimet institucionale, kostot ose detyrimet juridike të Palëve mund të detajohen nëpërmjet Aneksit – Kushtet e Përdorimit të Shërbimit.
3. Aneksi – Kushtet e Përdorimit të Shërbimit rregullon vetëm aspektet teknike dhe operative që lidhen me vendosjen, përdorimin dhe funksionimin e shërbimit dhe nuk mund të ndryshojë objektin e këtij Memorandumi apo të krijojë angazhime institucionale, financiare ose juridike shtesë për Palët.
4. Çdo mosmarrëveshje që lind nga interpretimi ose zbatimi i këtij Memorandumi zgjidhet fillimisht me konsultime ndërmjet Palëve. Në mungesë të një zgjidhjeje me mirëkuptim, zbatohet legjislacioni i Republikës së Shqipërisë dhe marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara dhe të zbatueshme në Republikën e Shqipërisë.
5. Nëse një dispozitë e këtij Memorandumi konsiderohet e pavlefshme ose e pazbatueshme, dispozitat e tjera mbeten në fuqi.
6. Dokumentacioni plotësues për zbatimin e projektit pilot mund të përfshijë, sipas rastit, Aneksin – Kushtet e Përdorimit të Shërbimit, planin e punës, informacionin përkatës mbi shërbimin, listën e burimeve të bazës së njohurive, kriteret e validimit/pranimit, informacionin mbi mbështetjen teknike, DPA/NDA kur kërkohen nga legjislacioni, procedurat e menaxhimit të incidenteve dhe dokumentacionin për përfundimin e përdorimit të shërbimit.
7. Në rast mospërputhjeje, ky Memorandum prevalon për çështjet institucionale dhe juridike; për mbrojtjen e të dhënave zbatohen kërkesat detyruese të legjislacionit në fuqi dhe, kur është e aplikueshme, DPA-ja; ndërsa për aspektet teknike dhe operative zbatohen kërkesat ligjore dhe kushtet e dakordësuara për përdorimin e shërbimit.
8. Ky Memorandum hartohet në dy kopje origjinale në gjuhën shqipe, me të njëjtën vlefshmëri, nga një për secilën Palë.

Konceptoi: DPBPMSP L.Haxhiymeri
DTMI O.Gega
Drejt Juridike E.Arapi





NËNSHKRIMET

PËR

Bashkinë Elbasan

KRYETARI I BASHKISË

Gledian Llatja

Datë: _____

Firma: _____



PËR


PROJEKTIN “BASHKI TË FORTA”

DREJTORI I PROGRAMIT

Norbert Pijls

Datë: _____

Firma: _____





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ELBASAN
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E E POLITIKAVE TË ZHVILLIMIT URBAN DHE
SHËRBIMEVE INFRASTRUKTURE
DREJTORIA E MBROJTJES CIVILE

Nr. 483/ Prot.

Elbasan më 28.08.2026

RELACION

**“Për miratimin e përdorimit të një pjesë të fondit të Emergjencave Civile për ndërtimin
godinës së stacionit të ri zjarrfikës në Njësinë Administrative Bradashesh”**

Të nderuar anëtarë të Këshillit Bashkiak,

Në kuadër të masave për forcimin e kapaciteteve vendore për parandalimin, përgatitjen dhe përballimin e situatave të emergjencave civile, si dhe për rritjen e gatishmërisë për përballimin e situatave të zjarreve në territorin e Bashkisë Elbasan, Drejtoria e Mbrojtjes Civile propozon përdorimin e shumës prej **10,243,226 (dhjetë milion e dyqind e dyzet e tre mijë e dyqind e njëzet e gjashtë) lekë** nga Fondi i Emergjencave Civile për ndërtimin godinës së stacionit të ri zjarrfikës në Njësinë Administrative Bradashesh. Godina e stacionit të ri do të jetë me përmasa 10*8 dhe lartësi 6 m, ku do të sistemohen automjete zjarrfikës dhe ambjentet e shërbimit për personelin (dhomë fjetje, kuzhinë, tualet). Trualli ku do të ndërtohet godina është pronë e bashkisë dhe ndodhet pranë godinës së Njësisë Administrative Bradashesh.

Ndërtimi i godinës në Njësinë Administrative Bradashesh paraqet një nevojë të rëndësishme për garantimin e sigurisë së komunitetit dhe forcimin e kapaciteteve të reagimit ndaj situatave të emergjencës, veçanërisht ndaj rrezikut nga zjarret në një zonë industriale.

Kjo nevojë lidhet edhe me specifikën e territorit të Bradasheshit dhe praninë e një numri subjektsh që ushtrojnë veprimtari prodhuese, përpunuese, magazinuese apo tregtuese të materialeve dhe produkteve me rrezikshmëri të lartë, të cilat, në kushte të caktuara, mund të përbëjnë burim potencial për përhapjen e zjarreve dhe krijimin e situatave me pasoja të rënda për jetën e njerëzve, pronën, mjedisin dhe aktivitetin ekonomik.

Prania e këtyre subjekteve, së bashku me aktivitetet industriale dhe ekonomike që zhvillohen në zonë, kërkon një nivel më të lartë gatishmërie dhe reagimi të shërbimit zjarrfikës, pasi ndërhyrja në rast zjarri duhet të jetë sa më e shpejtë, me qëllim parandalimin e përhapjes së flakëve dhe kufizimin e pasojave.

Në veçanti, në rastet kur një incident ndodh në ambiente ku prodhohen, magazinohen ose tregtohen materiale të rrezikshme, koha e reagimit është një faktor përcaktues për sigurinë e jetës së punonjësve dhe banorëve të zonës, si dhe për shmangien e përshkallëzimit të situatës.

Aktualisht, mbulimi i zonës nga strukturat zjarrfikëse ekzistuese nuk garanton në çdo rast një reagim sa më të shpejtë ndaj emergjencave që mund të ndodhin në territorin e Bradasheshit dhe

në zonat industriale përreth. Për këtë arsye, krijimi i një stacioni të ri zjarrfikës në Bradashesh do të shërbejë si një pikë e afërt dhe e dedikuar e reagimit operacional, duke reduktuar kohën e ndërhyrjes dhe duke rritur ndjeshëm kapacitetin për menaxhimin e situatave të zjarrit.

Ngritja e këtij stacioni do të ndikojë drejtpërdrejt në:

- uljen e kohës së reagimit ndaj rasteve të zjarrit;
- rritjen e sigurisë në zonat me aktivitet industrial dhe ekonomik;
- mbrojtjen e jetës dhe shëndetit të punonjësve dhe banorëve;
- kufizimin e dëmeve materiale dhe mjedisore;
- përmirësimin e mbulimit territorial me shërbim zjarrfikës;
- rritjen e kapaciteteve të Bashkisë Elbasan për parandalimin dhe përballimin e emergjencave civile.

Për sa më sipër, ndërtimi i godinës në funksion të shërbimit zjarrfikës në Bradashesh konsiderohet një ndërhyrje e nevojshme dhe me rëndësi të veçantë për marrjen e masave mbrojtëse dhe parandaluese për rritjen e sigurisë publike dhe të kapaciteteve vendore të reagimit ndaj zjarreve dhe situatave të tjera emergjente.

Duke vlerësuar rëndësinë e zonës së Bradasheshit, nevojën për rritjen e kapaciteteve të reagimit ndaj zjarreve dhe emergjencave të tjera, si dhe detyrimin e strukturave vendore për garantimin e mbrojtjes së jetës, shëndetit dhe pronës së qytetarëve, Drejtoria e Mbrojtjes Civile propozon miratimin e kalimit të shumës prej **10,243,226 (dhjetë milion e dyqind e dyzet e tre mijë e dyqind e njëzet e gjashtë)** lekë nga Fondi i Emergjencave Civile për ngritjen e Stacionit të Ri Zjarrfikës në Njësinë Administrative Bradashesh. Fondi prej **10,105,497** lekë do të shkojë për ndërtimin e objektit, **119,764** lekë për supervizim dhe **17,965** lekë për kolaudim.

Ky investim konsiderohet një ndërhyrje me rëndësi për rritjen e sigurisë së komunitetit, forcimin e infrastrukturës së mbrojtjes civile dhe përmirësimin e kapaciteteve të Bashkisë Elbasan për reagimin ndaj emergjencave.

Për sa më sipër, kërkojmë shqyrtimin dhe miratimin e këtij propozimi nga Këshilli Bashkiak Elbasan.

Duke Ju falenderuar,

<u>Konceptoi:</u>	Specialist	I. Hoxholli
<u>Miratoi:</u>	Drejtori MC	N. Sinani
<u>Konfirmoi:</u>	Drejtori PPMCMCBPK	Sh. Çullhaj

Me Urdhër e Porosi

ZV/KRYETARI

Asim Sula

KRYETARI
Gledian Llatja



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ELBASAN
KËSHILLI BASHKIAK

Adresa: Bashkia Elbasan, Rr. "Q.Stafa", Tel. +355 54 400152, e-mail bashkiaelbasan@elbasani.gov.al web:www.elbasani.gov.al

Nr. _____ Prot.

Elbasan më, _____._____.2026

PROJEKT VENDIM

Nr. _____ Datë _____._____.2026

**“Për miratimin e përdorimit të një pjesë të fondit të Emergjencave Civile për ndërtimin
godinës së stacionit të ri zjarrfikës në Njësinë Administrative Bradashesh”**

Në mbështetje të ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” nenet 8, 9, 54 të tij; ligjit
45/2019 “Për mbrojtjen civile” neni 7 të tij; si edhe pasi shqyrtoi relacionin dhe
dokumentacionin e paraqitur nga Drejtoria e Mbrojtjes Civile;

KËSHILLI BASHKIAK

VENDOSI

1. Miratimin e përdorimit e fondit prej **10,243,226 (dhjetë milion e dyqind e dyzet e tre mijë e dyqind e njëzet e gjashtë) lekë** nga buxheti i Emergjencave Civile për ngritjen e një stacioni të ri zjarrfikës në Njësinë Administrative Bradashesh i ndarë si më poshtë:

Ndërtimi i objektit : 10,105,497 lekë

Supervizimi: 119,764 lekë

Kolaudimi: 17,965 lekë

2. Fondin e mësipërm do të kalohet nga buxheti i Emergjencave Civile në buxhetin e Agjencisë e Mbikqyrjes dhe Kontrollit.
3. Burimi i financimit do të jetë Fondi i Emergjencës Civile buxheti i Bashkisë Elbasan miratuar me VKB nr. 154 datë 24.12.2025, “Për miratimin e buxhetit të Bashkisë

Elbasan për vitin 2026, si dhe Miratimin e Programit Buxhetor Afatmesëm përfundimtar për periudhën 2026-2028".

Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Buxhetit dhe Financës, Drejtoria e Prokurimeve dhe Investimeve dhe Agjencia e Mbikqyrjes dhe Kontrollit.

SEKRETARI I KËSHILLIT BASHKIAK

KRYETARI I KËSHILLIT BASHKIAK

Elsid Zyma

Lutfi Lala

<u>Konceptoi:</u>	Specialist	I. Hoxholli
<u>Pranoi:</u>	Drejtori MC	N. Sinani
<u>Miratoi:</u>	Dr. PPMCMBPK	Sh. Çullhaj
Dr. Buxhet Financë	A. Merkja	
Dr. Juridike	E. Arapi	
Dr. SHMZSH	E. Sota	
<u>Konfirmoi:</u>	Zv/Kryetari	K. Krasnika



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ELBASAN
AGJENCIA E SHËRBIMEVE PUBLIKE RURALE
DREJTORIA E PYJEVE DHE BUJQËSISË

Nr. 4860 Prot.

Elbasan, më 01.09.2026

RELACION

“Për miratim në parim të dhënies së pëlqimit për shfrytëzimin e pronave shtetërore në Njësinë Administrative Gjinar”

Të nderuar Këshilltar!

Bazuar në mbështetje të :

- Ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” neni 22 pika 1, neni 64/a;
- Ligjit nr. 111/2012 “Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore”, të ndryshuar;
- Ligjit nr. 10448, datë 14.07.2011 “Për mjedisin”, të ndryshuar;
- Ligjit nr. 57/2020, datë 30.04.2020 “Për pyjet”;
- Ligjit nr. 9693, datë 19.3.2007 “Për fondin kullësor”, të ndryshuar;
- V.K.M. nr. 550, datë 15.07.2020, “Për miratimin e formularëve të kërkesës për miratimin, nëparim, për dhënien me koncesion të përdorimit të burimit ujor, e lejes/autorizimit për përdorim burimi ujor, veprimtarinë ndërtimore në brigje, veprimtari në shtratin e burimit ujor, shkarkime të lëngshme, përdorimin dhe ripërdorimin e ujërave të përdorura, të adeqta të dokumenteve të kërkuara, të procedurës së shqyrtimit e të vendim marrjes, të formateve të lejes, të autorizimit, të kushteve të posaçme”
- Kërkesat e subjektit privat Bukaniku protokolluar ne Bashkinë Elbasan me nr 4800, date 26.08.2026

Subjekti privat **“Bukaniku”**, me NIPT **K83329801E**, ka paraqitur pranë Bashkisë Elbasan kërkesën e protokolluar me nr. **4800, datë 26.08.2026**, për marrjen e pëlqimit lidhur me shfrytëzimin e pronave shtetërore në të cilat shtrihet rrjeti inxhinierik i ujit të pijshëm, ky subject ushtron aktivitet në lidhje me shfrytëzimin dhe përdorimin e ujit të pijshëm për qëllime të butilimit të ujit.

Rrjeti inxhinierik i propozuar prej tij shtrihet në territorin e Njësisë Administrative Gjinar, Bashkia Elbasan, në një gjatësi totale prej rreth **4,600 metrash**, dhe prek disa pasuri fond pyjor publik ne pronësi te Bashkisë Elbasan. Konkretisht ne zonen kadastrale nr **1474 pasurine nr 10 dhe 18** te perfshire ne ekonominë pyjore **“Gjinar Zavaline”** dhe ne zonen kadastrale nr **1742 pasurine nr 193**, të përfshira në ekonominë pyjore **“Shpat 2”**.

Subjekti kerkon te pajiset me leje për përdorimin e ujit të pijshëm, ndërsa lloji i përdorimit të ujit është përcaktuar si **“Ujë i pijshëm për butilim”**. Në këtë kuadër, dhënia e pëlqimit nga Bashkia lidhet me shfrytëzimin e pasurive nëpër të cilat kalon rrjeti inxhinierik dhe jo me dhënien e të drejtës për përdorimin e burimit ujor, e cila rregullohet nëpërmjet legjislacionit për administrimin e burimeve ujore dhe autorizimeve/lejeve përkatëse të organeve kompetente.

Dhënia e pëlqimit në parim synon të mundësojë vijimin e procedurave administrative për lidhjen e marrëveshjes përkatëse ndërmjet subjektit dhe Bashkisë Elbasan, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe me kushtet që do të përcaktohen në dokumentacionin përkatës.

Për përdorimin e sipërfaqeve që përfshihen në fondin pyjor kombëtar, subjekti, pas përfitimit të lejeve dhe autorizimeve nga institucionet kompetente, do të lidhë kontratën përkatëse dhe do t'i nënshtrohet tarifimit sipas përcaktimeve të **V.K.M. nr. 559, datë 29.07.2022**, si dhe akteve të tjera ligjore e nënligjore që rregullojnë përdorimin e fondit pyjor kombëtar.

Në vlerësim të kërkesës së paraqitur, dokumentacionit të administruar dhe nevojës për vijimin e procedurave ligjore për përdorimin e pasurive publike, propozohet që **Këshilli Bashkiak Elbasan të miratojë në parim dhënien e pëlqimit** për shfrytëzimin e pronave shtetërore në të cilat shtrihet rrjeti inxhinierik i ujit të pijshëm në funksion të aktivitetit të subjektit "Bukaniku" në Njësinë Administrative Gjinar.


KRYETARI

Gledian Llatja

NË MUNGESË DHE ME URDHËR

ZV/KRYETARI

Klaudia Krasnika



Konceptoi:

A. Bitri

Pranoi:

J. Bodurri

Miratoi:

E. Hazizolli

BASHKIA ELBASAN
KËSHILLI BASHKIAK

P R O J E K T - V E N D I M

Nr. _____ datë _____ 2026

“Për miratim në parim të dhënies së pëlqimit për shfrytëzimin e pronave shtetërore në Njësinë Administrative Gjinar”

- Në mbështetje të ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” neni 22 pika 1, neni 64/a;
- ligjit nr. 111/2012 “Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore”, të ndryshuar;
- ligjit nr. 10448, datë 14.07.2011 “Për mjedisin”, të ndryshuar;
- ligjit nr. 57/2020, datë 30.04.2020 “Për pyjet”;
- ligjit nr. 9693, datë 19.3.2007 “Për fondin kullosor”, të ndryshuar;
- V.K.M. nr. 550, datë 15.07.2020, “Për miratimin e formularëve të kërkesës për miratimin, nëparim, për dhënien me koncesion të përdorimit të burimit ujor, e lejes/autorizimit për përdorim burimi ujor, veprimtarindërtimore në brigje, veprimtari në shtratin e burimit ujor,shkarkime të lëngshme, përdorimin dhe ripërdorimin e ujërave të përdorura, të ndotura, të dokumenteve shoqëruese, të procedurës së shqyrtimit e të vendimmarrjes,të formateve të lejes, të autorizimit, të kushteve të posaçme”
- Kërkesat e subjektit privat Bukaniku protokolluar ne Bashkinë Elbasan me nr 4800 date 26.08.2026

KËSHILLI BASHKIAK
V E N D O S I:

1. Të miratojë në parim dhënien e pëlqimit për shfrytëzimin e pronave shtetërore në të cilat shtrihet rrjeti inxhinierik i ujit të pijshëm në funksion të subjektit që ushtron aktivitet në Njësinë Administrative Gjinar.
2. Lista e pronave që subjekti do të lidhë marrëveshje me Bashkinë Elbasan do të jetë sipas tabelës së mëposhtme:

Nr.	Subjekti kërkuar	NIPT i subjektit	Gjatësia e tubacionit, pronë publike (m)	Leje e përdorimit të ujit të pijshëm	Lloji i ujit	Zona Kadastrale	Nr pasurise	Ekonomia Pyjore
1	Bukaniku	K83329801E	4600	leje	Ujë i pijshëm për butilim	1474	10 dhe 18	Gjinar- Zavaline
						1742	193	Shpat 2

3. Subjekti përfitues i lejes nga Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore (AMBU) do të lidhë kontratë e do të tarifohet sipas V.K.M.-së nr. 559, datë 29.07.2022, shtojca nr. 1, pika 10 “Për përcaktimin e çmimeve dhe tarifave për dhënien në shfrytëzim të fondit pyjor kombëtar, për veprimtari ekonomike si dhe për prodhimet drusore dhe jo drusore pyjore”.
4. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Pyjeve dhe Bujqësisë; Drejtoria Juridike.
5. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë mbas shpalljes publike (sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6, të Ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”).

Sekretari i Këshillit Bashkiak

Elsid Zyma

KRYETAR

Lutfi Lala

Konceptoi: A. Bitri

Pranoi: J. Bodurri

Miratoi: E. Hazizolli

Dr. Juridike E. Arapi

Miraturar me _____ vota

Vota Pro _____

Vota Kundër _____

Vota Abstenim _____

Zbardhur me datë ____ / ____ 2026



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ELBASAN
AGJENCIA SHËRBIMEVE PUBLIKE RURALE

Nr. 4785 Prot

Datë 22.08.2026

RELACION

“Për një shtesë në vendimin e VKB nr 16 dt.29.01.2025 “Për miratimin e normave dhe kritereve për disiplinimin e shpenzimeve për mjete motorrike në administrim të ASHPR.”

KËSHILLIT BASHKIAK

Të nderuar Këshilltarë,

Bazuar në ligjin Nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore” i ndryshuar, neni 54, të ligjit Nr.10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” dhe Udhëzimit të Ministrit të Financave Nr.30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”,

Komisioni për përcaktimin e normativave të mjeteve motorrike për vitin 2026 i ngritur sipas urdhërit të brendshëm nr.3 dt.06.01.2026 pasi bëri vlerësimin e harxhimit të karburantit për disa pajisje pune, si më poshtë:

1- Fadroma Case AUMT89 e blerë nga ASHPR (sipas procedurave të prokurimit për vitin 2026)

2- Mjetin teknologjik të pastrimit dhuratë nga Emir Shpk Tip.SCANIA P114VP1999.(sipas VKB nr.89 dt.25.06.2026)

3-2(dy) korrëse bari të transferuara nga Drejtoria e Përgjithshme e Kulturës dhe Sportit tek ASHPR me VKB nr.76 dt.04.06.2026

harto i procesverbalet përkatëse dhe vendosi që normativat e harxhimit të karburantit të jenë përkatësish si më poshtë:

Nr.	Mjeti Motorrik	Konsumi i Karburantit
1	FADROME CASE (NKJ570SVESKH45412) me targe AUMT89 Viti prodhimit 2025	9 litra /orë punë Gazoil D1
2	Mjet teknologjik për pastrimin e rrugëve. 12,8 T. Nr. Shasisë XLEP4X20004410437 Tip.SCANIA P114VP1999.	20 litra /orë pune Gazoil D1
3	Traktor për kositje bari motori Lancin IP75F vëllimi 224cc,Fuqia 4,5kw	2 litra/orë pune Benzinë
4	Korrëse bari GGP TWIN-CUT BILAMA TRAKTOR Vëllimi 414cc fuqia 7,1kw	3 litra/orë pune Benzinë

Bashkëngjitur relacionit janë procesverbalet përkatës.

Konceptoi: S.Finance Drilona Mema

P/Sek mekanik Gazmend Gaxhja

Pranoi:Drejtor Drejtorie/ Klaudio Tusha

Miratoi:Drejtori i Përgjithshëm/Altin Cenolli

Me urdhër e porosi

ZV/KRYETAR

Klaudia Krasnika

KRYETARI
Gledian Llatja



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ELBASAN
AGJENCIA SHERBIMEVE PUBLIKE RURALE

Nr. 05/3 Prot

Dt. 10.08.2026

PROCES VERBAL

Mbështetur në Ligjin Nr.139/2015,"Për vetëqeverisjen vendore; në Ligjin Nr 10296,datë 08.07.2010'Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik"për nevojat e përdorimit racional dhe të përditshëm të karburantit

Mbahet ky procesverbal në prani të komisionit të ngritur me urdhërin nr.3 dt 06.01.2026 nr prot.05

Anetarët e komisionit:

- Gazmend Gaxhja
- Drilona Mema
- Gejsi Luta

Në bazë të verifikimit të fakteve dhe provave konkludohet si më poshtë :

- Mjeti tip **Fadromë Case 570SV** me targë **AUMT89** harxhon **9 Litra/Orë** pune **Gazoil D1**

Në përcaktimin e normativave u mbajten parasysh tregues të rëndësishëm sic jane terreni dhe kushtet e operimit te mjetit.

KOMISION


Gazmend Gaxhja

Drilona Mema

Gejsi Luta

DREJTOR I PERGJITHSHEM

Altin Cepolli





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ELBASAN
AGJENCIA SHERBIMEVE PUBLIKE RURALE

Nr. 05/6 Prot

Dt. 10.08.2026

PROCES VERBAL

Mbështetur në Ligjin Nr.139/2015,"Për vetëqeverisjen vendore; në Ligjin Nr 10296,datë 08.07.2010"Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik"për nevojat e përdorimit racional dhe të përditshëm të karburantit

Mbahet ky procesverbal në prani të komisionit të ngritur me urdhërin nr.3 dt 06.01.2026 nr prot.05

Anetarët e komisionit:

- Gazmend Gaxhja
- Drilona Mema
- Gejsi Luta

Në bazë të verifikimit të fakteve dhe provave konkludohet si më poshtë :

- Mjeti tip **Scania P114VP1999** (Mjet teknologjik për pastrimin e rrugëve) me nr shasie **XLEP4X20004410437** harxhon **20 Litra/Orë** pune Gazoil **D1**

Në përcaktimin e normativave u mbajten parasysh normativat egzistuese,disa tregues të rëndësishëm sic jane viti i prodhimit ,tipi e lloji i mjetit,amortizimi i tij,gjendja reale teknike e mjetit ,natyra e punës për makinerinë e rënde,nevojat e përdorimit të funksioneve shtesë etj.

KOMISION

Gazmend Gaxhja

Drilona Mema

Gejsi Luta

DREJTOR I PERGJITHSHEM

Altin Cenolli





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ELBASAN
AGJENCIA SHERBIMEVE PUBLIKE RURALE

Nr. 05/ Prot

Dt. 10.08.2026

PROCES VERBAL

Për përcaktimin e normativave të konsumit të karburantit për mjetet motorrike

Mbështetur në Ligjin Nr. 139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore", si dhe në Ligjin Nr. 10296, datë 08.07.2010, "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik", për nevojat e përdorimit racional dhe të përditshëm të karburantit, mbahet ky procesverbal në prani të komisionit të ngritur me Urdhrin nr. 3, datë 06.01.2026, me nr. prot. 05

Anëtarët e Komisionit:

- Gazmend Gaxhja
- Drilona Mema
- Gejsi Luta

Në bazë të verifikimit të fakteve, dokumentacionit teknik dhe manualeve shoqëruese të mjeteve motorrike, komisioni konkludon si më poshtë:

Normativat e konsumit të karburantit:

Nr. Mjeti Motorrik

Konsumi i Karburantit

- | | | |
|---|---|--------------------------|
| 1 | Traktor për kositje bari motori Lancin IP75F vëllimi 224cc, Fuqia 4,5kw | 2 litra/orë pune Benzinë |
| 2 | Korrëse bari GGP TWIN-CUT BILAMA TRAKTOR Vëllimi 414cc fuqia 7,1kw | 3 litra/orë pune Benzinë |

Në përcaktimin e këtyre normativave janë marrë në konsideratë karakteristikat teknike të përcaktuara në manualët shoqëruese të mjeteve motorrike, si dhe terreni e kushtet konkrete ku do të përdoren.

Traktori për kositje bari motori Lancin IP75F vëllimi 224cc, Fuqia 4,5kw dhe korrësja e barit GGP TWIN-CUT BILAMA TRAKTOR Vëllimi 414cc fuqia 7,1kw do të përdoren nga Sektori i terreneve sportive.

Ky procesverbal mbahet në 3 kopje dhe pasi u lexua, nënshkruhet nga anëtarët e komisionit.

KOMISION


Gazmend Gaxhja

Drilona Mema

Gejsi Luta

DREJTOR I PERGJITHSHEM

Altin Cenolli





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK ELBASAN

Nr. ____ Prot

Datë __. __. 2026

PROJEKTVENDIM

Nr. ____ Datë __. __. 2026

“Për një shtesë në vendimin e VKB nr 16 dt.29.01.2025 “Për miratimin e normave dhe kritereve për disiplinimin e shpenzimeve për mjete motorrike në administrim të ASHPR.”

Bazuar në ligjin Nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore” i ndryshuar, neni 54, të **ligjit Nr.10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”** dhe Udhëzimit të Ministrit të Financave Nr.30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”,

Relacionit të paraqitur nga ASHPR nr. ____ datë: _____

VENDOSI :

1. Të miratojë normën e harxhimit të karburantit për mjetet përkatësisht si më poshtë:

Nr.	Mjeti Motorrik	Konsumi i Karburantit
1	FADROME CASE (NKJ570SVESKH45412) me targe AUMT89 Viti prodhimit 2025	9 litra /orë punë Gazoil D1
2	Mjet teknologjik për pastrimin e rrugëve. 12,8 T. Nr. Shasisë XLEP4X20004410437 Tip.SCANIA P114VP1999.	20 litra /orë pune Gazoil D1
3	Traktor për kositje bari motori Lancin IP75F vëllimi 224cc,Fuqia 4,5kw	2 litra/orë pune Benzinë
4	Korrëse bari GGP TWIN-CUT BILAMA TRAKTOR Vëllimi 414cc fuqia 7,1kw	3 litra/orë pune Benzinë

2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Agjencia e Shërbimeve Publike Rurale _.

3. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

Konceptoi: S.Finance Drilona Mema

P/Sek mekanik Gazmend Gaxhja

Pranoi:Drejtor Drejtorie/ Klaudio Tusha

Miratoi:Drejtori i Përgjithshëm/Altin Cenolli

Konfirmoi: Zv.Kryetar Klaudia Krasnika

Sekretari i Këshillit Bashkiak

Kryetari i Këshillit Bashkiak

ELSID ZYMA

LUTFI LALA



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ELBASAN
AGJENCIA E MBIKËQYRJES DHE KONTROLLIT

Nr. 4843

Elbasan më 02.09.2026

RELACION

“Për përcaktimin e normave dhe kritereve për disiplinimin e shpenzimeve për automjetet zjarrfikëse Isuzu me targ AC 627 AH dh Isuzu me targ AC 632 AH në Drejtorinë e Shërbimit të MZSH-së, Agjencisë Mbikëqyrjes dhe Kontrollit”

KËSHILLIT BASHKIAK

Të nderuar Këshilltarë,

Mbështetur ne ligjin Nr. 139/2015, “ per vetëqeverisjen vendore”,ligjin 152/2015 “ per sherbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe shpetimin”, ligjin Nr. 10296, date 08.07.2010 “ per menaxhimin financiar dhe kontrollin” neni 4 pika 26 dhe, udhezimin e Ministrise Finacave Nr.30 date 27.12.2011, “ per menaxhimin e aktiveve ne njesit e sektorit publik”.

Drejtoria e Shërbimit të MZSH-së nisur nga fakti i marrjes së dy mjeteve të reja zjarrfikëse, për për disiplinimin e shpenzimeve, për nevojat e përdorimit racional dhe të përditshëm të karburantit për autmjetet zjarrfikëse kërkojmë të përcaktojmë normativat e harxhimit të karburantit nga automjetet zjarrfikëse

Relacion mbahet në zbatim të urdhërit Nr. 87, date 31.08.2026, të Drejtorit të Përgjithshëm "Për caktimin e normativës së harxhimit të karburantit për automjetet zjarrfikëse Isuzu me targ AC632 AH dhe Isuzu me targ AC 627 AH"

Në zbatim të këtij urdhëri komisioni bazuar dhe ne dokumentacionin shoqerues te prodhuesit te mjeteve beri provat perkatese per te dy mjetet zjarrfikes dhe hartoi proces-verbalet e normativave të harxhimit të karburantit. Keto normativa do te zbatohen per periudhen 01.09.2026 deri me 31.12.2026.

Tabela permbledhese e të dhënave për konsumin e karburantit të mjeteve zjarrfikëse sipas proces - verbaleve për vitin 2026.

Nr	Targa e mjetit	Tipi I mjetit	Norma e konsumit	Karburanti
1	AC 627 AH	Isuzu 5500 litra	20 Litra /100km dhe per 1 ore pune dhe 1 ore ndezja ne vend 10 Litra	Gazoil D1
2	AC 632 AH	Isuzu 3500 litra	18 Litra /100km dhe per 1 ore pune dhe 1 ore ndezja ne vend 8 Litra	Gazoil D1

Për trajtimin e mjeteve zjarrfikëse, për mbajtjen e tyre në gatishmëri, provat për funksionimin e agregateve shtese (pompa), për karikim baterish, qarkullim vaji, mjetet për vitin 2026 duhet të ndizen dy herë në ditë për 15 minuta gjithsej nga data 1 shtator deri në datën 14 Nëntor dhe, nga data 15 Nëntor deri më datë 31 Dhjetor duhet të ndizen tre herë në ditë për 25 minuta gjithsej.

**MIRATOHET
ZV/KRYETARI**

Asim Sula

Konceptoi:

Shef.Sek.Ndërh. G.Ruda

Dr. MZSH E.Sota

Pranoi:

Dr. AMK L.Dervishi





**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ELBASAN
KËSHILLI BASHKIAK**

Nr. _____ Prot.

Elbasan, më ____ . ____ 2026

PROJEKT-VENDIM

Nr. _____ datë ____ . ____ 2026

“ Për një shtesë në vendimin Nr.28, datë 02.03.2026 për miratimin e normave dhe kritereve për disiplinimin e shpenzimeve për automjetet në administratën e Agjencisë Mbikëqyrjes dhe Kontrollit”

Këshilli Bashkiak në mbledhjen e tij të datës ____ . ____ .2026, pasi mori në shqyrtim relacionin e paraqitur nga Agjencia e Mbikëqyrjes dhe kontrollit “Për përcaktimin e normave dhe kritereve për disiplinimin e shpenzimeve për automjetet zjarrfikëse Isuzu me targ AC 627 AH dh Isuzu metarg AC 632 AH në Drejtorinë e Shërbimit të MZSH-së, Agjencisë Mbikëqyrjes dhe Kontrollit”, bazuar në ligjin nr.139/2015 “për vetëqeverisjen vendore” (I ndryshuar), në ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “ për menaxhimin financiar dhe kontrollin” (I ndryshuar) dhe Udhëzimin e Ministris së Financave nr. 30, datë 27.12.2011 “ për menaxhimin e aktiveve në njësit e sektorit public” (I ndryshuar);

V E N D O S I:

1. Të miratojë normativat e konsumit të karburantit për automjetet zjarrfikëse sipas relacionit përkatës për vitin 2026 sipas tabelës më poshtë

Nr	Targa e mjetit	Tipi I mjetit	Norma e konsumit	Karburanti
1	AC 627 AH	Isuzu 5500 litra	20 Litra /100km dhe per 1 ore pune dhe 1 ore ndezja ne vend 10 Litra	Gazoil D1
2	AC 632 AH	Isuzu 3500 litra	18 Litra /100km dhe per 1 ore pune dhe 1 ore ndezja ne vend 8 Litra	Gazoil D1

2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Agjencia e Mbikëqyrjes dhe Kontrollit dhe Drejtoria e Shërbimit të Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimin.
4. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

SEKRETARI

Elsid Zyma

KRYETARI

Lutfi LALA

Konceptoi:

DSHZ K.Shinplaku

Shëf.Sek.Ndërh. G.Ruda

Pranoi:

Dr. MZSH E.Sota

Konfirmoi:

Dr.Përgj. L.Dervishi



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ELBASAN
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE
Drejtoria Juridike, Burimeve Njerëzore dhe Informacionit
Spektori Administratës dhe Burimeve Njerëzore

Nr. 4769 Prot.

Elbasan, më 24.08. 2026

RELACION

“Për shtesë në numrin e punonjësve të Agjencisë së Shërbimeve Publike Rurale, si dhe Policisë Bashkiake të Bashkisë Elbasan “

Drejtuar:
Këshillit Bashkiak
ELBASAN

Të nderuar këshilltarë!

Bazuar në:

1. Nenin 100 të Kushtetutës;
2. Ligjin nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", neni 54, pika "dh";
3. Ligjin nr.44/2015 "Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë";
4. Ligjin nr.9936 datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë" (i ndryshuar);
5. Ligjin nr.10296, datë 8.7.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin" (i ndryshuar);
6. Vendimin e Këshillit Bashkiak nr.155 , datë 24.12.2025 “ Mbi miratimin e numrit maksimal të punonjësve të Bashkisë Elbasan, dhe Njësive operative vartëse të saj, si dhe saktësimin e emërtesave të njësive operative në tabegave, nivelet e pagave të funksionarëve të zgjedhur pse të emëruar të nëpunësve civilë e të punonjësve të Bashkisë dhe njësive operative vartëse të saj për vitin 2026“
7. Kërkesa nr.729 prot., datë 21.07.2026“ Për shtesë numri punonjësish në Agjencinë e Shërbimeve Publike Rurale“
8. Kërkesa nr. 813 prot., datë 17.08.2026“ Shtesë punonjësish në Drejtorinë Shkimbin e Lartë në Agjencinë e Shërbimeve Publike Rurale“
9. Kërkesa nr. 700 prot., datë 31.07.2026 “ Për shtesë numri pranë Policisë Bashkiake“

Ju paraqesim propozimin e mëposhtëm:

1.Duke marrë në konsideratë zgjerimin e fushës së veprimtarisë së Agjencisë së Shërbimeve Publike Rurale, rritjen e volumit të punës, si dhe nevojën për garantimin e një shërbimi sa më cilësor për komunitetin në zonat rurale kërkojmë miratimin e shtesës së mëposhtme:

- 1(një) shofer manovrator për fadromën në sektorin e rrugëve duke qenë se gjatë vitit 2026 kemi shtesë të mjeteve të cilat aktualisht hasin vështirësi në përdorim për mungesë të shoferëve.

- 3 (tre) punonjës në sektorin e pastrimit konkretisht në zonat turistike për të shtuar dhe përmirësuar shërbimin,
- 2(dy) punonjës për Njësinë Administrative Gjinar
- 1(një) punonjës për Njësinë Administrative Tregan.
- 5 (pesë) punonjës për mirëmbajtjen e rrugëve , rasishtjen e barit , pastrimin e kanaleve dhe menxhimin e çdo problematike në zonat .Papër, Gracen, Labinot-Mal.

Persa i përket përballimit financiar të kësaj shtese, ju bëjmë me dije se nga data 01.09.2026 deri më 31.12.2026 fondi i pagave përballohet nga buxheti i miratuar i vitit 2026 të agjencisë.


Duke vlerësuar domosdoshmërinë e këtyre pozicioneve për mbarrëvajtjen e veprimtarisë së Agjencisë së Shërbimeve Publike Rurale kërkojmë miratimin e kësaj kërkesë

2. Duke marrë në konsideratë rritjen e ndjeshme të ngarkesës në terren të Policisë Bashkiake është krijuar një mbingarkesë e stafit aktual e cila vështirëson përmbushjen me efikasitet në detyrat institucionale. Kjo ngarkesë e punës është rritur si pasojë e monitorimit dhe zbatimit të ri të parkimit me pagesë në rrugë dhe sheshe publike në territorin e Bashkisë Elbasan i cili është implemtuar në një numër të konsiderueshëm rrugësh dhe hapësirash publike të qytetit duke kërkuar angazhimin e vazhdueshëm të punonjësve të policisë bashkiake për kontrollin e çdo automjeti që nuk kryen pagesën e përcaktuar, kontrollin e vazhdueshëm të parkimeve të gabuara në territorin e qytetit dhe marrjes së masave administrative për çdo shkelës, si dhe kontrollin e shitësve ambulantë të cilët zënë dhe pengojnë trotualet dhe hapësirat publike me qëllim lëvizjen e lirë të këmbësorëve.

Duke e vlerësuar situatën aktuale dhe nevojën për rritjen e stafit kërkojmë shtimin me 7(shtatë) punonjës të Policisë Bashkiake, ku fondi i pagave do të përballohet nga buxheti i miratuar nga viti 2026. Ky shtim do të kontribuonte ndjeshëm në rritjen e efikasitetit të shërbimit, përmirësimin e mbulimit territorial, si dhe në përmbushjen me cilësi dhe në kohë të detyrave institucionale në shërbim të komunitetit.

Duke besuar në mirkuptimin Tuaj dhe duke Ju falenderuar për bashkëpunimin!

Konceptoi: Përgjegjëse ABNJ DABNJ: M. Biba
 Pranoi: Drejtor JBNJ: E. Arapi
 Miratoi: Dr. i Përgj: S. Mehmeti
 Dr. i Përgj. AMK L. Dervishi





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ELBASAN
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE
Drejtoria Juridike, Burimeve Njerëzore dhe Informacionit
Sektori Administratës dhe Burimeve Njerëzore

Nr. _____ Prot

Elbasan, më ____/____/2026

PROJEKT – VENDIM

Nr. _____ datë ____/____/2026

“Për shtesë në numrin e punonjësve të Agjencisë së Shërbimeve Publike Rurale, si dhe Policisë Bashkiake të Bashkisë Elbasan “

Në mbështetje të ligjit nr. 139/2015”Për vetqeverisjen vendore:, neni 8, pika 2, neni 9, pika 1.1, gërma”ç”, neni 27, neni 33, neni 54, gërma “d” dhe”dh”, ligji nr. 9936 date 26.06.2008”Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, neni 3, pika 8, si dhe të ligjit nr. 10296 date 08.07.2010”Për menaxhimin financiar dhe kontrollin “, bazuar në relacionin e Sektorit të Administratës dhe Burimeve Njerëzore në mbledhjen e tij të datës ____/____/____ pasi mori në shqyrtim propozimin, Këshilli Bashkiak i Bashkisë Elbasan.

VENDOSI:

1. Shtesën me 10 (dhjetë) punonjës në strukturën e Agjencisë së Shërbimeve Publike Rurale ku numri maksimal i punonjësve të kësaj agjencie nga 177 punonjës në 187 punonjës
2. Shtesën me 7 (shatë) punonjës në strukturën e Policisë Bashkiake ku numri i punonjësve nga 38 punonjës në 45 punonjës.
3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Sektori i Administratës dhe Burimeve Njerëzore, Agjencia e Shërbimeve Publike Rurale, Agjencia e Mbikqyrjes dhe Kontrollit, si dhe Drejtoria e Buxhetit dhe Financës.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Konceptoi: Përgjegjëse ABNJ M.Biba

Pranoi: Drejtor JBNJ: E.Arapi

Miratoi: Dr. i Përgj: S.Mehmeti

Dr. Përgj ASHPR A.Cenolli

Dr. Përgj. AMK L.Dervishi

Konfirmoi: Zv/Kryetar K.Krasnika

Sekretari

Elsid Zyma

Kryetari

Lutfi Lala



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ELBASAN
DREJTORIA BUXHET FINANCË

Nr. 4784 Prot.

Elbasan, më 25. 08. 2026

RELACION

“Rritje e të ardhurave dhe e shpenzimeve në buxhetin e vitit 2026, me burim financimi të huaj”

KËSHILLIT BASHKIAK

Të nderuar këshilltarë,

Në zbatim të ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, ligjit nr. 68/2017, datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, si dhe Udhëzimit nr. 10, datë 12.07.2024, të Ministrisë së Financave “Për regjistrimin, përdorimin, rakordimin, raportimin dhe publikimin e fondeve të financimeve të huaja në kuadër të marrëveshjeve ndërkombëtare”, midis Bashkisë Elbasan dhe Bashkimit European (LP-LEPIDA SCPA, Bolonjë) është lidhur Marrëveshja e Partneritetit nr.5780, datë 05.12.2024, për projektin “Administratat publike përballen me transformimin dixhital si komunitet në zonën e Adrionit”, programi: IPA Adrion 00131.

Sipas marrëveshjes me donatorët, alokimi i fondeve do të bëhet me disa këste, dhe aktualisht është alokuar kësti i tretë, në shumën 1,980,563.64 lekë.

Në respektim të buxhetit të përcaktuar në këtë marrëveshje, kërkohet **rritje e të ardhurave dhe e shpenzimeve në buxhetin e vitit 2026**, në vlerën 1,980,563.64 lekë, me burim financimi të huaj, kësti i tretë, detajuar si më poshte:

Të ardhurat:

Emërtimi i të ardhurave	Institucioni	Kodi institucionit	Viti 2026 (lekë)
Financim i huaj Projekti: “Administratat publike përballen me transformimin dixhital si komunitet në zonën e Adrionit”, programi: IPA Adrion 00131. (kësti i tretë)	Bashkia	2109001	1,980,564

Shpenzimet :

Gr	Prog.	Funks.	Produkti	Kap.	Art.	Institucioni	shuma (lekë)
00	AA109	01110	P111AAV	2	600	Bashkia	1,266,000
00	AA109	01110	P111AAV	2	601	Bashkia	306,000
00	AA109	01110	P111AAV	2	602	Bashkia	408,564
						Gjithsej :	1,980,564

Për sa më sipër, kërkojme miratimin Tuaj për rritjen e të ardhurave dhe të shpenzimeve, **me burim financimi të huaj**, pjesë e buxhetit të Bashkisë Elbasan për vitin 2026.

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin!

Koncept. P/Sekt. Buxhetit: M. Behluli

Dr. Buxhet Financë: A. Merkja

Dr. i Përgjithshëm: S. Mehmeti

ZV/KRYETARI
Klaudia Krasnika



REPUBLIKA E SHQIPERISË
BASHKIA ELBASAN
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. _____ Prot.

Datë _____ .09. 2026

P/VENDIM

NR. _____ DATË _____ .09. 2026

PËR

**“RRITJE E TË ARDHURAVE DHE E SHPENZIMEVE NË BUXHETIN E VITIT 2026,
ME BURIM FINANCIMI TË HUAJ,”**

Në zbatim të ligjit nr.139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, ligjin nr.9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, ligjit nr.68/2017, datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, Udhëzimin Nr. 10, datë 12.7.2024, i Ministrisë së Financave “Për regjistrimin, përdorimin, rakordimin, raportimin dhe publikimin e fondeve të financimeve të huaja në kuadër të marrëveshjeve ndërkombëtare”,

VENDOSI

1. Të miratojë rritjen e të ardhurave dhe të shpenzimeve në buxhetin e Bashkisë Elbasan për vitin 2026, me burim financimi të huaj, si më poshtë:

A. Të ardhura : **1,980,564 lekë.**

- Projekti: “Administratat publike përballen me transformimin dixhital si komunitet në zonën e Adrionit”, programi: IPA Adrion 00131.

B. Shpenzime : **1,980,564 lekë**

Detajimi i shpenzimeve:

Gr	Prog.	Funks.	Produkti	Kap.	Art.	Institucioni	shuma (lekë)
00	AA109	01110	P111AAV	2	600	Bashkia	1,266,000
00	AA109	01110	P111AAV	2	601	Bashkia	306,000
00	AA109	01110	P111AAV	2	602	Bashkia	408,564
						Gjithsej :	1,980,564


2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria Buxhet Financë.
3. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes së tij.

Sekt.Buxhetit: M.Behluli

Dr.Buxhet Financë: A.Merkja

Dr.Juridike: E. Arapi

Zv/kryetar: K. Krasnika



SEKRETAR
Elsid Zyma

KRYETAR
Lutfi Lala



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ELBASAN
DDREJTORIA BUXHET FINANCË
SEKTORI I BUXHETIT

Nr. 4874 prot.

Elbasan më 02. 09. 2026

RELACION

Transferim fonde në buxhetin e vitit 2026 dhe periudhën afatmesme 2027-2028”, si dhe detajim i shtesës së grantit”.

KËSHILLIT BASHKIAK

Të nderuar Këshilltarë !

A)

Në zbatim të ligjit nr. 87/2025 “Për buxhetin e vitit 2026”, i ndryshuar, Urdhërit nr.382, datë 20.07.2026, të Ministrisë së Arsimit “Për shpërndarjen e financimit për projekte të reja, me cikël financimi 2026-2028, thirrja e parë, nga programet “Arsimi Bazë” dhe “Arsimi i Mesëm” për infrastrukturën shkollore, në bashkëfinancim me vetëqeverisjen vendore, Bashkia Elbasan është shpallur fituese e tre projekteve të reja për arsimin, përcjellë me shkresën nr.4235/10, datë 20.07.2026 të Ministrisë së Arsimit, për objektet si më poshtë :

1. “Rikonstruksion i godinës ekzistuese dhe shtesë anësore + mensa si dhe ndërtim i ri 2 katësh i kopështit në territorin e shkollës 9-vjecare “Abdyl Paralloi”, vlera e plotë e projektit 281,598,557 lekë, nga të cilat 201,198,918 lekë Ministria e Arsimit dhe 80,399,639 lekë Bashkia Elbasan, financim 2026-2028.
2. “Rikonstruksion i objektit ekzistues dhe vendosja e shkallëve të emergjencës në godinën e shkollës 9-vjecare “Sul Misiri”, vlera e plotë e projektit 93,249,604 lekë, nga të cilat 69,937,203 lekë Ministria e Arsimit dhe 23,312,401 lekë Bashkia Elbasan, financim 2026-2028.
3. Rikonstruksion i godinës ekzistuese dhe i murit rrethues, ndërtimim i shkallës së emergjencës dhe montim i ashensorit, në godinën e shkollës se mesme “Vasil Kamami”, vlera e plotë e projektit 214,549,408 lekë, nga të cilat 160,912,056 lekë Ministria e Arsimit dhe 53,637,352 lekë Bashkia Elbasan, financim 2026-2028.

Referuar shkresës nr.4235/10, datë 20.07.2026 të Ministrisë së Arsimit, të sipërcituar, në total, për të tre objektet, me cikël financimi 2026-2028, Ministria e Arsimit ka financuar 432,048,177 lekë, ndërsa Bashkia Elbasan duhet të financojë 157,349,392 lekë, pa përfshirë supervizimin dhe kolaudimin e objekteve, të cilat janë pjesë e financimit të vetëqeverisjes vendore.

Bazuar në shkresën nr.4287, datë 28.07.2026 të Drejtorisë së Projektimit Urban, vlera e supervizimit dhe kolaudit për të tre objektet, referuar preventivave përkatës, është 4,843,394 lekë.

Në total, pjesa takuese e bashkëfinancimit të Bashkisë Elbasan, për periudhën 2026 -2028 është 162,192,786 lekë (157,349,392 lekë për objektet + 4,843,394 lekë supervizim dhe kolaudim).

Në buxhetin e vitit 2026, miratuar nga Ju me vendimin nr.154, datë 26.12.2024, është planifikuar "Rikonstruksion objekte arsimore, në bashkëfinancim me MASH", për shumën 12,000,000 lekë, kështu që diferenca duhet financuar duke bërë transferime në buxhet.

Referuar vendimit nr.887, datë 27.12.2022, të Këshillit të Ministrave "Për procedurat e menaxhimit të investimeve Publike", i ndryshuar, sipas të cilit njësia e vetëqeverisjes vendore duhet të obligojë fondet në sistemin e thesarit, në masën jo më pak se 20% për vitin 2026, të pjesës takuese të bashkëfinancimit të NJQV-së, ju propozojmë këtë detajim të objekteve për periudhën 2026-2028 :

	Emertimi projektit	Vlera e plote	Kontribut Bashkia Elb.	Viti 2026	Viti 2027	Viti 2028
1	Rikonstruksion i godinës ekzistuese dhe shtesë anësore + mensa si dhe ndërtim i ri 2 katësh i kopështit në territorin e shkollës 9-vjecare "Abdyl Paralloi",	281,598,557	80,399,639	16,399,639	32,000,000	32,000,000
	supervizim	1,900,135	1,900,135	1,000,000	900,135	0
	kolaudim	285,020	285,020	0	285,020	0
2	Rikonstruksion i objektit ekzistues dhe vendosja e shkallëve të emergjencës në godinën e shkollës 9-vjecare "Sul Misiri".	93,249,604	23,312,401	4,612,401	9,700,000	9,000,000
	supervizim	758,104	758,104	400,000	358,104	0
	kolaudim	113,716	113,716	0	113,716	0
3	Rikonstruksion i godinës ekzistuese dhe i murit rrethues, ndërtim i shkallës së emergjencës dhe montim i ashensorit, në godinën e shkollës së mesme "Vasil Kamami",	214,549,408	53,637,352	15,637,352	19,000,000	19,000,000
	supervizim	1,553,408	1,553,408	1,000,000	553,408	0
	kolaudim	233,011	233,011	0	233,011	0
Totali :		594,240,963	162,192,786	39,049,392	63,143,394	60,000,000

Sikurse shikohet nga tabela e mësipërme, pjesa e bashkëfinancimit të Bashkisë Elbasan për vitin 2026 është 39,049,392 lekë. Për të financuar këtë vlerë, Ju propozojmë transferimin e fondeve të lira në buxhetin e këtij viti, si më poshtë :

Paksohet : (në lekë)

12,000,000	“Rikonstruksion objekte arsimore, në bashkëfinancim me MASH”
17,705,044	“ Rikonstruksion godina e Qendrës Sociale “Balashe” (tepricë prokurimi)
44,348	supervizim “ “ “ (tepricë prokurimi)
8,500,000	“Sistemi i kamerave për koshat e mbetjeve të ngurta”
800,000	“Rivitalizimi urban i shesheve në anën veriore të unazës Jugore(tepricë prok.)
39,049,392	Total viti 2026

B)

1. Në vijim të kërkesës së Lëvizjes Rinore Egjiptiane dhe Rome, lidhur me mundësinë e investimit në pajisje Smart Board për institucionet arsimore si dhe nisur nga nevojat e identifikuara nga Bashkia Elbasan për përmirësimin e infrastrukturës teknologjike, me shkresën nr.3936/1, datë 07.08.2026, Drejtoria e Arsimit, Shëndetësisë dhe Rinisë, kërkon miratimi i fondit **2,000,000 lekë**, për blerjen e 13 pajisjeve Smart Board. Pajisjet parashikohet të vendosen kryesisht në institucionet arsimore si dhe një pjesë e tyre në Sallën e Këshillit Bashkiak dhe Sallën Multifunkionale.

2. Në kuadër të pasurimit të kalendarit artistik dhe kulturor të Bashkisë Elbasan, si dhe me synimin për të ruajtur, promovuar dhe përcjellë vlerat e trashëgimisë kulturore dhe artistike të qytetit tonë, Drejtoria e Përgjithshme e Kulturës dhe Sportit, nëpërmjet shkresave nr.265, datë 07.08.2026 dhe nr.271, datë 13.08.2026, propozon realizimin e disa veprimtarive me rëndësi të veçantë, gjatë periudhës së mbetur të vitit, që synojnë jo vetëm gjallërimin e jetës kulturore të qytetit, por edhe promovimin e identitetit artistik të Elbasanit. Për realizimin e tyre, kërkohet mbështetje financiare për veprimtaritë e mëposhtme :

- “Festivali Kombëtar i Këngës Popullore Qytetare “Elbasan 2026”, fondi i kërkuar është **1,000,000 lekë**. Është një nga aktivitetet më të rëndësishme të traditës muzikore të qytetit dhe zhvillohet një herë në dy vjet. Ky aktivitet mbledh artistë, interpretues dhe përfaqësues të kësaj gjinie nga treva të ndryshme shqiptare. Veprimtaria është pjesë e kalendarit të aktiviteteve kulturore kombëtare dhe realizohet në bashkëpunim me Qendrën Kombëtare të Veprimtarive Tradicionale, në varësi të ministrisë përgjegjëse për kulturën.

- “Koncerti “Mehdi Zena dhe Miqtë”, fondi i kërkuar është **1,000,000 lekë**. Ky koncert konceptohet si një veprimtari artistike, kushtuar muzikës folklorike dhe qytetare të trevës së Elbasanit.

Pjesmarrja e artistëve dhe bashkëpunëtorëve të ndryshëm, do ta kthiejnë këtë koncert në një takim mes traditës, interpretuesve të njohur dhe publikut, duke synuar të evidentojë pasurinë e traditës sonë muzikore, folklorin, zakonet dhe identitetin kulturor të trevës.

Gjithashtu, kjo drejtori kërkon miratimin e fondit **700,000 lekë**, për Klubin Shumësporte, në zërin shpenzime, “Qera banese për sportistët e huaj”, si pasojë e marrjes së sportistëve të huaj për ekipet sportive të klubit, me qëllim rritjen e cilësisë sportive.

3. Me shkresën nr.831/1, datë 20.08.2026, ASHPR kërkon miratimin e fondit **2,948,315 lekë**, me qëllim realizimin e projektit “Blerje pajisje dhe materiale për Fushën e Sportit”, bazuar në kërkesën e Sektorit Mirëmbajtje Terrene Sportive. Referuar preventivit të hartuar për këtë projekt, ky fond ndahet në 2,278,315 lekë investime “Blerje pajisje për Fushën e Sportit” dhe 670,000 lekë “Materiale për Fushën e Sportit”, në zërin shpenzime. Realizimi i këtij projekti synon përmirësimin e kushteve në ambientet e terreneve sportive.

4. Në kuadër të përgatitjes dhe krijimit e kushteve sa më të favorshme për fillimin e vitit të ri shkollor, Drejtoria e Përgjithshme e Arsimit Parashkollor kërkon shtesë të fondit në zërin shpenzime operative për “Blerje materiale për riparim dhe shërbim tavolina nxënësish dhe karrigesh”, për shkollat 9-vjeçare”. Fondi i kërkuar për këtë qëllim është **500,000 lekë**, bazuar në shkresën nr.273, datë 14.08.2026 të DPAP “Kërkesë për shtesë fondi në zërin e shpenzimeve në buxhetin e vitit 2026”.
5. Në buxhetin e viti 2026 është miratuar investimi me objekt “Sistemim asfaltim i rrugëve në zonat rurale të Njësisë Administrative, (rruga Salla dhe Reformës në fshatin Hajdaran; rruga fshatit Polis i Vogel; rruga e lagjes së Sinanëve dhe Xhakallarëve Mlizë, etj.”, me fond limit 300,468,360 lekë, me 3 vite financim 2026-2028. Për vitin 2026 janë planifikuar 61,000,000 lekë, ose 20% e vlerës së objektit. Në kuadër të realizimit të investimeve në infrastrukturën rrugore, gjatë rishikimit të nevojave dhe përditësimit të projektit është evidentuar nevoja për shtesa të gjatësive të rrugës, për përfitim të më shumë banoreve nga këto investime si dhe për rrjedhojë është rishikuar projektimi i veprave të artit, të nevojshme për qëndrueshmërinë dhe realizimin e plotë dhe funksional të ndërhyrjeve të parashikuara.

Ky investim përfshin :

- rruga Salla dhe e Reformës në fshatin Hajdaran
- rruga në fshatin Polis i Vogel
- rruga e lagjes së Sinanëve dhe Xhakallarëve në fshatin Mlizë
- rruga në shkollën e mesme dhe 9-vjeçare në fshatin Kuqan
- rruga në fshatin Kështjellë
- rruga në lagjen Gorricë në fshatin Gjergjan
- rrugë e brendshme Llixha Hidrait në fshatin Kycyk
- rruga në fshatin Petresh
- rruga Papër Dambe
- rruga e shkollës dhe e nënstacionit në fshatin Vidhas
- rruga në fshatin Dopaj
- rruga në fshatin Samurr
- rruga në fshatin Griqan -Labinot- Katund
- rruga e varrezave Labinot Katund
- rruga Ura Shqaut në fshatin Gjinar
- rruga e Ballajve në fshatin Kryezjarr
- rruga e pallateve në fshatin Shushicë
- rruga në fshatin Bathës dhe rruga Tudan- shkolla 9- vjeçare Trepsenisht.

Bazuar në shkresën nr.4830, datë 28.08.2026 të Drejtorisë së Projektimit Urban, vlera sipas preventivit përfundimtar, pas rishikimit të projektit “Sistemim - asfaltim i rrugëve në zonat rurale të Njësisë Administrative”, është 518,106,136 lekë, ose 217,637,776 lekë me shumë se fondi i miratuar në buxhetin e viti 2026, me financim 2026-2028.

Meqenese ky objekt është parashikuar me financim 2026-2028, për vitin 2026 kërkohet të financohet 20% e vlerës së objektit, ose **42,621,227 lekë** më shumë se parashikimi në buxhet (518,106,136* 20% - 61,000,000).

Gjithashtu, kërkohet shtesë për shumën 3,156,585 lekë, supervizim dhe kolaudim i objektit, me financim 2026-2028, ose për vitin 2026 financimi është **1,000,000 lekë** supervizim.

❖ **Për financimin e kërkesave të mësipërme (pika B), Ju propozojmë transferimin e fondeve të lira në buxhetin e vitit 2026, si më poshtë :**

1. Objekti “Ndërtimi i dy segmenteve paralele në Bulevardin "Aqif Pasha", PDV 1/27”, me 3 vite financim, 2026-2028, është pjesë e segmentit rrugor të miratuar me PDV-në nr.27, dhe është akoma e paqartë situata në lidhje me gjendjen e pronësisë. Për këtë arsye ky projekt do të shtyhet për periudhën 2027-2029, duke lënë të lirë financimin e vitit 2026 për shumën **16,137,500 lekë**.
2. Në buxhetin e vitit 2026 është miratuar objekti “Ndërtim i markatës së re”, (bashkëfinancim me Ministrinë e Bujqësisë, me dy vite financimi 2026-2027). Fondi i miratuar për vitin 2026 është **20,000,000 lekë**, i cili nuk mund të realizohet pasi projekti do të rivlerësohet nga një grup arkitektësh dhe do të rikonceptohet për një zgjidhje afatgjatë dhe më të qëndrueshme për qytetin.
3. Nga prokurimi i objektit “Ndërtimi i rrugës së re nga Rotonda e Varrezave deri në intersektimin me rrugën “Nos Josifi”, lagja "Emin Matraxhiu" (financim 2026-2028), rezulton **4,400,000 lekë** diferencë midis fondit limit dhe vlerës së fituesit (tepricë prokurimi), fond i cili rezulton i lirë për vitin 2026.
4. Në buxhetin e vitit 2026 është miratuar objekti “Bashkëfinancim për rikonstruksionin e plotë të teatrit “Skampa”, me fond limit **6,900,000 lekë**. Meqenëse ky objekt është akoma në fazën e rishikimit të projektit, në këto kushte nuk mund të arrihen afatet e prokurimit për vitin 2026, duke lënë të lirë pjesën e bashkëfinancimit të Bashkisë Elbasan për këtë vit.
5. Në buxhetin e vitit 2026 është parashikuar pagesa e shërbimit të borxhit (interesa) për kredinë e padisburuar, në lidhje me shpronësimet, Nga verifikimi i rasteve të pritshme rezulton të kemi tepricë të fondeve në buxhetin e këtij viti, e për këtë arsye propozojmë të paksojmë përkatësisht shumën **575,264 lekë** interesa, të cilat do të përdoren për financimin e kërkesave të mësipërme.
6. Në zbatim të Aktit Normativ nr.2, datë 30.06.2026 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.87/2025 “Për buxhetin e vitit 2026”, dhe Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.9, datë 20.03.2018 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, për Bashkinë Elbasan është akorduar fondi **3,756,778 lekë, transfertë e pakushtëzuar e përgjithshme**, përcjellë me shkresën e Ministrisë së Financave nr.11214/3, datë 06.07.2026. *E ardhur si transfertë e pakushtëzuar, bashkitë kanë pavarësi të plotë të destinacionit të përdorimit të këtij fondi.*

Në tabelat bashkëlidhur relacionit, Ju do të gjeni shpenzimet dhe investimet sipas objekteve, të cilat i janë nënshtruar rishikimit (paksime dhe shtesa) që kanë të bëjnë me transferim fonde në buxhetin e Bashkisë Elbasan për vitin 2026, si dhe tabelën e detajimit të fondit të akorduar nga transfertat e pakushtëzuar e përgjithshme (grant), shtesë për vitin 2026.

Për sa më sipër, bazuar në ligjin nr.139/2015, datë 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore", ligjin nr.9936, datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", udhëzimin nr.2, datë 14.01.2026 të Ministrisë së Financave "Për zbatimin e buxhetit të vitit 2026" dhe vendimin e Këshillit Bashkiak nr.154, datë 24.12.2025 për "Miratimin e Buxhetit të Bashkisë Elbasan për vitin 2026, si dhe miratimin e Programit Buxhetor Afatmesëm përfundimtar për periudhën 2026-2028", i ndryshuar, Ju propozojmë të miratoni "Transferimin e fondeve në buxhetin e vitit 2026 dhe periudhën afatmesme 2027-2028", si dhe detajim i shtesës së grantit", sipas tabelave bashkëlidhur projekt vendimit.

Duke Ju falënderuar për bashkëpunimin !


P.Sekt.Buxhetit : M.Behluli

Dr. Buxh. Fin. : A.Merkja

D.P. Sh.M : S. Mehmeti



ZV. KRYETAR
Klaudia Krasnika





**REPUBLIKA E SHQIPERISË
BASHKIA ELBASAN
KËSHILLI BASHKIAK**

Nr. _____ Prot.

Datë _____ .09. 2026

P/VENDIM

NR. _____ DATE _____ . 09. 2026

MBI

**“Transferim fonde në buxhetin e vitit 2026 dhe periudhën afatmesme 2027-2028”, si dhe
detajim i shtesës së grantit ”.**

Këshilli Bashkiak në mbledhjen e tij të datës ____ .09.2026, pasi mori në shqyrtim materialin e paraqitur nga Bashkia Elbasan mbi “Transferim fonde për investime në buxhetin e vitit 2026, dhe periudhën afatmesme 2027-2028, si dhe detajim i shtesës së grantit”, bazuar në ligjin nr.139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, ligjin nr.9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, ligjin nr.68/2017, datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, “Udhëzimin plotësues nr.2, datë 14.01.2026 të Ministrisë së Financave “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2026”, vendimin e Këshillit Bashkiak nr.154, datë 24.12.2025, për “Miratimin e Buxhetit të Bashkisë Elbasan dhe Këshillit Bashkiak për vitin 2026, si dhe miratimin e Programit Buxhetor Afatmesëm 2026-2028”, i ndryshuar, si dhe shkresën e Ministrisë së Financave nr.11214/3, datë 06.07.2026,

VENDOSI

1. Transferimin e fondeve në buxhetin e vitit 2026 dhe periudhën afatmesme 2027-2028, grant dhe të ardhura, njësia shpenzuese Bashkia dhe insitucionet vartëse, sipas tabelës nr.1, bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Detajimin e fondit 3756,778 lekë, transfertë e pakushtëzuar e përgjithshme për vitin 2026, sipas tabelës nr.2, bashkëlidhur këtij vendimi.
3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Sektori i Buxhetit, Drejtoria e Prokurimeve dhe njësitë vartëse.
4. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes së tij.

P/Sekt.Buxhetit : M.Behluli

Dr.Buxh.Fin. : A.Merkja

Dr.Juridike: E. Arapi

SEKRETAR
Elsid Zyma

KRYETAR
Lutfi Lala

Tab. Nr.1
 "Transferim fonde në buxhetin e vitit 2026 dhe periudhën afatmesme 2027-2028"

ne leke

PAKSIME :

Gr	Progr.	Funks.	Produkt	Kap	Art	Kodi instit.	Institucioni	Shuma/2026	2027	2028	Total
00	AG109	09120	V912AAK	5	231	"Rikonstruksion objekte asimore, në bashkëfinancim me MASH"	Bashkia	12,000,000			12,000,000
00	AH109	10430	V043AAF	5	231	"Rikonstruksion godina e Qendres Sociale "Balashe", financ. 2026-2028 (tepricë prok.)	ASHS	17,705,044			17,705,044
00	AH109	10430	V043AAF	5	231	Supervizim "Rikonstruksion godina e Qendres Sociale "Balashe" (tepricë prok.)	ASHS	44,348			44,348
00	AE109	06260	V626AAF	5	231	"Sistemi i kamerave për koshat e mbetjeve të ngurta"	Bashkia	8,500,000			8,500,000
00	AC109	04520	V452AAC	5	231	"Rivitalizimi Urban i shesheve në anën veriore të unazës Jugore, ndërtim dhe kryezim i tërësisë dhe rrugës "25 Nëntori" (tepricë prok.)	ASHPU	800,000			800,000
00	AC109	04520	V452AAC	5	231	"Ndërtimi i dy segmenteve paralele në Bulevardin "Adif Pasha", PDV 1/27 (3 vite financim 2026-2028)	ASHPU	16,137,500			16,137,500
00	AC109	04160	V416AAA	5	231	"Ndërtim i markatës së re (bashkëfinancim me Ministrinë e Bujqësisë, 20% kontribut i Bashkisë, me dy vite financim 2026-2027)	Bashkia	20,000,000			20,000,000
00	AC109	04520	V452AAC	5	231	"Ndërtimi i rrugës së re nga "Rotonda e varrezave" deri në intersektimin me rrugën "Nos Josif", lagja "Ermin Matrahxhiu", financim 2026-2028 (tepricë prokurimi)	ASHPU	4,400,000			4,400,000
00	AF109	08230	V823AAB	5	231	"Sistemi i kamerave për rikonstruksionin e plotë të teatrit "Skampa"	DPKS	6,900,000			6,900,000
00	ACA09	01710	V171AAB	5	651	Sherbimi i borxhit (interesa)	Bashkia	575,264			575,264
00	AC109	04520	V452AAC	1+5	231	"Sistemin asfaltim i rrugëve në zonat rurale të Njësive Administrative, (rruga Salla dhe Reformës në fshatin Hajdaran, rruga e fshatit Polis i Vogël, Rruga e lagjes Simanëve dhe Xhakallareve Mlizë)", projekti = 300,468,360 lekë, financim 2026-2028, viti 2026=61,000,000 lekë (28,000,000 grant + 33,000,000 të ardhura).	ASHPR	61,000,000	120,000,000	119,468,360	300,468,360
Totali :								148,062,156	120,000,000	119,468,360	387,530,516

ne leke

SHITESA:

Gr	Progr.	Funks.	Produkt	Kap	Art	Kodi instit.	Institucioni	Shuma/2026	2027	2028	Total
00	AG109	09120	V912AAK	5	231	"Rikonstruksion i godinës ekzistuese dhe shtesë anësore + mensa si dhe ndërtim i ri 2 katesh i kopeshtit në territorin e shkollës 9-vjeçare "Abdyj Parailoi" (vlera e objektit 281,598,557 lekë, financim 2026-2028, bashkëfinancim me MA)	Bashkia	16,399,639	32,000,000	32,000,000	80,399,639
00	AG109	09120	V912AAK	5	231	supervizim " "	Bashkia	1,000,000	900,135		1,900,135
00	AG109	09120	V912AAK	5	231	kolaudim " "	Bashkia		285,020		285,020
00	AG109	09120	V912AAK	5	231	"Rikonstruksion i objektit ekzistues dhe vendosja e shkallëve të emergjencës në godinën e shkollës 9-vjeçare "Sui Misiri", (vlera e objektit 93,249,604 lekë, financim 2026-2028, bashkëfinancim me MA)	Bashkia	4,612,401	9,700,000	9,000,000	23,312,401
00	AG109	09120	V912AAK	5	231	supervizim " "	Bashkia	400,000	358,104		758,104
00	AG109	09120	V912AAK	5	231	kolaudim " "	Bashkia		113,716		113,716
00	AG109	09120	V912AAK	5	231	"Rikonstruksion i godinës ekzistuese dhe i murit rrethues, ndërtimin i shkallës së emergjencës dhe montim i ashtensorit, në godinën e shkollës së mesme "Vasil Kamari", (vlera e objektit 214,549,408 lekë, financim 2026-2028, bashkëfinancim me MA)	Bashkia	15,637,352	19,000,000	19,000,000	53,637,352
00	AG109	09230	V923AAB	5	231	supervizim " "	Bashkia	1,000,000	553,408		1,553,408
00	AG109	09230	V923AAB	5	231	kolaudim " "	Bashkia		233,011		233,011
00	AG109	09230	V923AAB	5	231	"Blerje pajisje Smart Board"	DP4	2,000,000			2,000,000
00	AG109	09120	V912AAK	5	231	"Festivali Kombëtar i Këngës Popullore Qytetare "Elbasan 2026"	DPKS (Q.arti)	1,000,000			1,000,000
00	AF109	08230	V823AAB	5	602	"Koncerti "Mehdi Zena dhe Migje"	DPKS (Q.arti)	1,000,000			1,000,000
00	AF109	08230	V823AAB	5	602	"Qera banese për sportistët e huaj"	DPKS (Sport Kl.)	700,000			700,000
00	AE09	06260	V626AAF	5	602	"Blerje materiale për Fushën e Sportit"	ASHPR	670,000			670,000

00	AE09	06260	V626AAF	5	231	"Blerje pajisje për Fushën e Sportit"	ASHPR	2,278,315			2,278,315
00	AC109	09120	V912AAB	5	602	"Blerje materiale për riparim dhe shërbim tavolina dhe karrige nënshesh"	DP4	500,000			500,000
00	AC109	04520	V452AAC	1+5	231	"Sistemin Asfalitim i rrugëve në zonat rurale të Njësisë Administrative", projekti = 518,106,136 leke, financim 2026-2028, viti 2026= 103,621,227 leke (28,000,000 grant + 71,864,449 të ardhura + 3,756,778 grant shtesë 2026).	ASHPR	99,864,449	207,000,000	207,106,136	513,970,585
00	AC109	04520	V452AAC	5	231	Supervizim	ASHPR	1,000,000	1,818,380		2,818,380
00	AC109	04520	V452AAC	5	231	Kolaudim	ASHPR			338,206	338,206
Totali :								148,062,156	271,961,774	267,444,342	687,468,272

P/Shtet. Bashkësit: U. Beteus. Ja.

Tab. Nr.2

"Detajim i shiteses se grantit (transferte e pakushtezuar e perqitshme) per vitin 2026.

SHTESA:

ne leke

Gr	Progr.	Funks.	Produk.	Kap	Art	Kodi insit.	Institucioni	Shuma/2026
00	AC109	04520	V452AAC	1	231	"Sistemim Asfaltim i rrugeve Zona Rurale te Njesive Administrative", projekti = 518,106,136 leke, financim 2026-2028, viti 2026= 103,621,227 leke (28,000,000 grant + 71,864,449 te ardhura + 3,756,778 grant shese 2026).	ASHPR	3,756,778.00
Totali :								3,756,778.00

P/ Selct. Bashkete : C. Beut, de